


# ANKETIMI DELIBERATIV 'SHQIPËRIA N'KUVENDIM'

RAPORTI I GJETJEVE



**AUTORËT**  
**Gjergji Vurmo**  
Autori kryesor

**Besjana Kuçi**  
Bashkautore

**Tiranë, Shkurt 2022**

© 2022 nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)  
Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, Nd. 35, H.1  
1017 Tirana, Albania  
E-mail: info@idmalbania.org  
Website: www.idmalbania.org



## SHËNIM

*Ky raport u përgatit nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). Pikëpamjet dhe përfundimet që jepen në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Autorësia e këtij botimi i përket vetëm IDM-së. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo lloj forme ose me çfarëdo lloj mjete pa lejen paraprake me shkrim të IDM-së.*

### NJË PROJEKT NGA



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC

*"Mbështetje për Parlamentin dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri"  
(PACEP), është një projekt nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Prezenca e OSBE në  
Shqipëri dhe Instituti Demokratik Amerikan (NDI)."*

### ZBATUAR NGA



### PARTNERË NË ZBATIM



*Ky aktivitet u zhvillua nga IDM në kuadër  
të projektit PACEP, në konsultim me  
Qendrën për Demokraci Deliberative  
pranë Universitetit të Stanford (ShBA).*

**Bordi Këshillimor i Anketimit Deliberativ**  
**Dr. Edlira Gjoni**, Drejtore Ekzekutive, Impact Center  
**Neritan Sejamini**, Themelues, Exit.al  
**Dr. Blendi Ceka**, Lektor, Universiteti i Tirana, Fakulteti i Shkencave Sociale  
**Dr. Elona Dhembo**, Lektore, Universiteti i Tirana, Fakulteti i Shkencave Sociale  
**Dr. Marsela Dauti**, Lektore, Universiteti i Tirana, Fakulteti i Shkencave Sociale  
**Gjergj Erebara**, Kryeredaktor, BIRN Albania  
**Elert Yzeiri**, Kryeredaktor, A2CNN

### Ekipi i ekspertëve për materialet informuese

**Dr. Edlira Gjoni**, Drejtore Ekzekutive, Impact Center  
**Neritan Sejamini**, Themelues, Exit.al

**Rezart Kapedani**, Ekspert mjedisi, Brooks Hannas & Partners  
**Dr. Endrit Shabani**

### Koordinimi i punës në terren

**Dior Angjeli**, Hulumtues, IDM  
**Sheila Hafizi**, Ndihmës-hulumtuese, IDM

### Këshilltarë të Projektit

**Sotiraq Hroni**, Drejtor Ekzekutiv, IDM  
**Dr Rinor Beka**, Këshilltar i Programit, NDI Shqipëri

### Mbështetja dhe orientimi metodologjik

**Prof. James S. Fishkin**, Drejtor, Qendra për Demokraci Deliberative, Universiteti Stanford  
**Dr. Alice Siu**, Zv. Drejtore, Qendra për Demokraci Deliberative, Universiteti Stanford

# PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE</b>	<b>5</b>
<b>HYRJE</b>	<b>8</b>
<b>METODOLOGJIA</b>	<b>10</b>
ANKETIMI KOMBËTAR	10
ANKETIMI I GRUPIT EKSPERIMENTAL DHE AKTIVITETI 'SHQIPËRIA N'KUVENDIM'	11
ANKETIMI I GRUPIT TË KONTROLLIT	12
TESTI-T PËR NDRYSHORET E PAVARURA TË ANKETIMEVE TË GRUPIT EKSPERIMENTAL DHE AI I KONTROLLIT	12
<b>CJETJET E USHTRIMIT TË PARË NË SHQIPËRI TË ANKETIMIT DELIBERATIV</b>	<b>13</b>
ANGAZHIMI QYTETAR NË VEPRIMTARINË PARLAMENTARE	13
MBIKËQYRJA PARLAMENTARE	19
DEMOKRACIA E BRENDSHME E PARTIVE POLITIKE	23
REFORMA E SISTEMIT ZGJEDHOR	28
VOTA E DIASPORËS	33
MJEDISI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE	36
IMIGRIMI EKONOMIK NË SHQIPËRI	39
MËSIMET NGA USHTRIMI I PARË I ANKETIMIT DELIBERATIV NË SHQIPËRI	43
<b>SHTOJCAT</b>	<b>47</b>

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Popullsia rezidente në 1 janar 2019 dhe 1 janar 2021 dhe madhësia e kampionit sipas qarkut	11
Tabela 2: Mbështetja për masat e propozuara për angazhimin qytetar në vendimmarrjen parlamentare (anketimi kombëtar)	16
Tabela 3: Mbështetja për masat e propozuara për forcimin e mbikëqyrjes parlamentare	20
Tabela 4: Niveli i dakordësisë për masat që synojnë llogaridhënien dhe demokracinë e brendshme të partive politike (Anketimi kombëtar)	25
Tabela 5: Mbështetja për ndryshimin e sistemit zgjedhor (Anketimi kombëtar)	30
Tabela 6: Mbështetja për votimin e diasporës (anketimi kombëtar)	34
Tabela 7: Qëndrimet ndaj problemeve të imigrimit ekonomik (anketimi kombëtar)	41

## LISTA E FIGURAVE


Figura 1: Mesatarja për qëndrimet e ndryshuara – grupi eksperimental krahasuar me grupin e kontrollit	5
Figura 2: Mesatarja për qëndrimet e pandryshuara të të anketuarve – grupi eksperimental krahasuar me grupin e kontrollit	6
Figura 3: Sa besim keni se Parlamenti në përgjithësi bën atë që është e drejtë (gjënë e duhur)? (N=1192)	14
Figura 4: Sa kuptoni ju personalisht nga ajo që ndodh në politikë dhe Parlament? (%) (N= 1196)	14
Figura 5: Sipas Rregullores së Funkcionimit të Kuvendit, a mund të merrni pjesë ju si qytetar në mbledhjet e komisioneve të përhershme parlamentare? (N= 689)	15
Figura 6: Shqipëri nuk ka miratuar ligj për ... (%) (N=638)	16
Figura 7: Mesatarja për propozimet për pjesëmarrjen e qytetarëve - Grupi eksperimental krahasuar me grupin e kontrollit	17
Figura 8: Sa njohuri keni për rolin kontrollues dhe mbikëqyrës të Parlamentit mbi qeverinë? (%) (Anketimi kombëtar) N= 1156	19
Figura 9: Mesatarja për forcimin e mbikëqyrjes parlamentare - Grupi eksperimental krahasuar me grupin e kontrollit	21
Figura 10: Në përgjithësi, sa i/e kënaqur jeni me mënyrën si funksionon demokracia në Shqipëri? (%) (Anketimi kombëtar, N=1193)	23
Figura 11: A votuat në zgjedhjet e fundit parlamentare? (%) (Anketimi kombëtar, N = 1091)	24
Figura 12: Në përgjithësi, sa njohuri keni për organizimin e brendshëm të partive politike në Shqipëri? (%) (Anketimi kombëtar, N = 1182)	25
Figura 13: Mesatarja për propozimet për demokracinë e brendshme të partive politike - Grupi eksperimental krahasuar me grupin e kontrollit	26
Figura 14: Sipas ligjit për partitë politike, cili është organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive? (%) (N=908)	27
Figura 15: 32. Sipas ndarjes administrativo-territorial të vitit 2014 Shqipëria përbëhet nga... (%) (N=830)	28
Figura 16: Cilat nga të mëposhtmet (nëse ka) janë të vërteta për sistemin që përdoret aktualisht për zgjedhjen e deputetëve të Kuvendit?? (%) (N=1200)	29
Figura 17: Sa të informuar mendoni se janë deputetët për prioritetet dhe shqetësimet e qytetarëve në vend? (%) (N=1178)	29
Figura 18: Sa të gatshëm do të ishit për të kontaktuar me politikanë ose deputetë qoftë fizikisht, qoftë me shkrim apo në forma të tjera? (%) (N=1168)	30
Figura 19: Mesatarja për propozimet për reformën zgjedhore - Grupi eksperimental krahasuar me grupin e kontrollit	31
Figura 20: Sipas Kodit Zgjedhor, a mund të votojë diaspora shqiptare (qytetarë shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit) në zgjedhjet vendore dhe parlamentare në Shqipëri? (%)	33
Figura 21: Mesatarja për zbatimin e formave për votimin e diasporës - Grupi eksperimental krahasuar me grupin e kontrollit	35
Figura 22: A ka Shqipëria ndonjë ligj për ndryshimet klimatike? (%)	36
Figura 23: Ndotja në zonën vendore krahasuar me ngrohjen globale	37
Figura 24: Mesatarja për propozimet për ndryshimet klimatike - Grupi eksperimental krahasuar me grupin e kontrollit	38
Figura 25: Sipas mendimit tuaj, ligji i ri për të huajt (2021) në Shqipëri lehtëson? (%) (N=656)	40
Figura 26: Në vitin 2020, sa ishte niveli i papunësisë në Shqipëri? (%) (N=836)	40
Figura 27: Mesatarja për imigrantët ekonomikë - Grupi eksperimental krahasuar me grupin e kontrollit.	41
Figura 28: Grupi eksperimental krahasuar me grupin e kontrollit – pikët mesatare të dallimeve dhe qëndrimeve të përbashkëta ndaj propozimeve për ndryshim	43
Figura 29: Gatishmëria për të lexuar apo për të dëgjuar këndvështrime të ndryshme të çështjeve politike? (Anketim kombëtar, N=1182) krahasuar me gatishmërinë për të ndryshuar apo rishikuar aspekte të bindjeve personale politike? (Anketim kombëtar, N=1154) (%)	45

# PËRMBLEDHJE

Realizimi i anketimit deliberativ na ndihmon të kuptojmë dinamikat e perceptimeve dhe qëndrimeve të publikut ndaj politikëbërjes dhe në ç'masë ndikohen ato nga informacioni dhe njohuritë, përfshirë këtu edhe faktorët që mund të parandalojnë ndryshimin e opinionit publik. Nga njëzetë propozime të politikave që kanë si synim reformën ose trajtimin e problematikave të rëndësishme në kuadër të tematikave të synuara, në më shumë se gjysmën e tyre (njëmbëdhjetë) u evidentuan dallime të mëdha mes pjesëmarrësve të grupit eksperimental (që kishin mundësi të diskutonin dhe të merrnin informacione të tjera nga ekspertët dhe në materialet informuese) dhe pjesëmarrësve nga grupi i kontrollit. Kjo do të thotë se pjesëmarrësit që morën njohuri të reja dhe ndërvepruan me anëtarët e tjerë të grupit dhe me ekspertët e pavarur shfaqën qëndrime dhe pozicione të ndryshme në krahasim me ata që nuk iu dha kjo mundësi.

Pjesëmarrësit e grupit eksperimental, që kishin mundësi të merrnin informacione të reja nëpërmjet aktivitetit katër-ditor në nëntor 2021, patën qëndrime krejtësisht të ndryshme me grupin e kontrollit për tema të tilla si demokracia e brendshme e partive politike, mekanizmat e demokracisë së drejtpërdrejtë dhe mbikëqyrja parlamentare. Është me interes të theksohet se informacionet e reja duket se kanë ndikuar që pjesëmarrësit të jenë më mbështetës ndaj një pohimi të caktuar (propozimi) në krahasim me pjesëmarrësit e grupit të kontrollit për pjesën më të madhe të propozimeve të politikave (pohimet) të paraqitura nga ky anketim. Megjithatë, për një numër të vogël propozimesh, ndryshimi ishte në kahun e kundërt dhe pjesëmarrësit e grupit eksperimental ishin më pak mbështetës se ata të grupit të kontrollit. Në figurën 1 jepet një pamje grafike e ndryshimeve të dukshme të qëndrimit, ndryshime që erdhën si rrjedhojë e diskutimeve dhe informacioneve të reja që patën pjesëmarrësit e grupit eksperimental.

**FIGURA 1: MESATARJA PËR QËNDRIMET E NDRYSHUARA – GRUPI EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT**



*Shënim: Të anketuarve iu kërkua të jepnin vlerësimin e tyre për çdo masë të propozuar (pohim) në një shkallë nga 0 – e kundërshtoj tërësisht në 10 – e mbështes plotësisht.*

Nga ana tjetër, nuk u vu re ndonjë ndryshim i madh në qëndrimet që kanë të bëjnë me temat që janë relativisht të reja në debatin publik në Shqipëri, të tilla si ndryshimet klimatike dhe imigrimi ekonomik. Këtu mund të ketë luajtur rol ndërgjegjësimi i pamjaftueshëm i publikut, duke qenë se vlerat mesatare për pjesën më të madhe të propozimeve silleshin rreth vlerave neutrale (5 deri në 6) në një shkallë nga 0 në 10. Gjithsesi, kjo nuk vlente për pjesën më të madhe të pohimeve që patën një ndryshim në qëndrimet e pjesëmarrësve nga grupi eksperimental, mesataret e të cilëve varionin në

vlerat 7 dhe 9.

Pjesëmarrësit e grupit eksperimental nuk shfaqën ndonjë ndryshim qëndrimi ndaj pjesës më të madhe të propozimeve për proceset zgjedhore – një nga temat më polarizuese të tre dekadave të fundit që ka nxitur debat të ashpër politik dhe publik.

Në Figurën 2 tregohen vlerat mesatare dhe dallimet statistikisht të pakonsiderueshme mes të anketuarve nga grupi eksperimental dhe grupi i kontrollit për secilin nga propozimet.

**FIGURA 2: MESATARJA PËR QËNDRIMET E PANDRYSHUARA TË TË ANKETUARVE – GRUPI EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT**



*Shënim: Të anketuarve iu kërkua të jepnin vlerësimin e tyre për çdo masë të propozuar (pohimë) në një shkallë nga 0 e kundërshtoj tërësisht në 10 e mbështes plotësisht.*

Për sa i përket çështjes së angazhimit qytetar në veprimtarinë e Parlamentit, ka pasur dallime mes pjesëmarrësve të grupit eksperimental dhe atyre të grupit të kontrollit. Pra, të anketuarit nga grupi eksperimental treguan mbështetje më të madhe për pohimet si *“Tu mundësohet zgjedhësve që të nënshkruajnë peticione online dhe të detyrojnë Parlamentin të diskutojë për çështje të rëndësishme për publikun”*; *“Vendosja e detyrimit për të organizuar referendume për çështje të rëndësishme”* dhe *“Parashikimi i një buxheti (fonde publike) të veçantë për të mbuluar kostot e nisjes së një referendumi apo nismës ligjore qytetare.”*

Dallime të ngjashme vihen re edhe për dy nga tre propozimet për forcimin e mbikëqyrjes parlamentare të ekzekutivit. Më konkretisht, pjesëmarrësit e grupit eksperimental raportuan mbështetje më të madhe për propozimet si *“T’i mundësohet opozitës që të kryesojë të paktën 1/3 e komisioneve parlamentare”*, dhe *“Krerët e institucioneve të pavarura (të cilët ndihmojnë kontrollin dhe llogaridhënien e ekzekutivit) të zgjidhen me shumicë të cilësuar (2/3) e votave në Parlament.”*

Për sa i përket temës së përmirësimit të llogaridhënies dhe demokracisë së brendshme të

partive politike, të dhënat nga grupi eksperimental dhe ai i kontrollit konfirmojnë dallime të mëdha mes këtyre dy grupeve për të tre masat e propozuara, *"Të vendosen mekanizma konkurrimi brenda partive politike (p.sh., primaret e kandidatëve për zgjedhjet vendore dhe kombëtare)"; "Të rritet financimi publik për partitë dhe kandidatët" dhe "Të certifikohen financat e partive politike nga kompani ndërkombëtare"*. Është me interes të theksohet se për dy pohimet e fundit nga eksperimenti u konstatua se sa më shumë informacione t'u jepeshin pjesëmarrësve të grupit eksperimental në aktivitetin "Shqipëria n'Kuvendim" aq më shumë ndikoheshin ata duke treguar më pak mbështetje në krahasim me pjesëmarrësit e grupit të kontrollit.

Të dhënat e hulumtimit tregojnë se qëndrimet e pjesëmarrësve të grupit eksperimental ndryshojnë nga ato të pjesëmarrësve të grupit të kontrollit për dy, nga katër opsionet për ndryshimin e sistemit aktual zgjedhor. Nuk u vunë re dallime të mëdha në qëndrimet e këtyre grupeve për propozimet si *"Kalimi nga sistemi aktual proporcional rajonal në sistemin proporcional kombëtar (me vetëm një listë kombëtare)" dhe "Rikthimi në sistemin e mëparshëm zgjedhor me zgjedhjen e 100 deputetëve me sistem mazhoritar dhe 40 me sistem proporcional."* Nga ana tjetër, të anketuarit nga grupi eksperimental dhanë mbështetje më të madhe se ata në grupin e kontrollit për propozimet si *"Kalimi tek listat plotësisht të hapura në sistemin aktual zgjedhor" dhe "Kalimi në sistem të pastër mazhoritar (deputeti i çdo zone zgjidhet me shumicën e votave të qytetarëve)."*

Për tre nga katër metodat për mundësimin e votës së diasporës nuk u evidentuan dallime të mëdha, bazuar në testin-t. Niveli i mbështetjes për pohimin *"Votimi pranë misioneve diplomatike të Shqipërisë në shtetet e huaja", "Votim me postë të zakonshme" dhe "Votimi elektronik"* mbeti i pandryshuar pas marrjes nga pjesëmarrësit të informacionit objektiv dhe të njohurive për to. Propozimi i të pasurit të *"vende të dedikuara në parlament për të cilat diaspora të votojë dhe të zgjidhet."* shfaqti dallime të konsiderueshme mes dy grupeve të eksperimentit social. Kështu, pjesëmarrësit e grupit eksperimental e mbështetën këtë propozim më shumë sesa ata në grupin e kontrollit, të cilët nuk morën informacione të tjera përmes materialeve informuese ose diskutimeve me anëtarë të grupit dhe nga ekspertë të pavarur.

Tema e ndryshimeve klimatike mbetet mjaft e re në debatin publik në Shqipëri dhe qytetarët mund të kenë nevojë për më shumë kohë dhe

informacione për të trajtuar sfidat që vijnë prej këtyre ndryshimeve. Në një shkallë nga 0 - e kundërshtoj tërësisht në 10 - e mbështes plotësisht, të gjithë pjesëmarrësit prireshin të qëndronin rreth vlerave neutrale të boshtit (mesatarja = 5 deri në 6) për pjesën më të madhe të masave të propozuara, të tilla si p.sh., *"të bëhet i detyrueshëm emetimi zero i karbonit për makinat, kamionët, autobusët deri në 2035", "të ndalohej importi i makinave të përdorura më shumë se 5 vjet", dhe "të krijohet zona me emetim të ulët në qendrat e mëdha urbane"*. Për më tepër, testi-t nuk nxori në pah dallime të mëdha mes të anketuarve nga grupi eksperimental dhe ai i kontrollit për të gjitha masat e propozuara për uljen e ndikimit të ndryshimeve klimatike.

Të dhënat nga grupi eksperimental dhe ai i kontrollit tregojnë për një qëndrim më konservator ndaj imigrimit të punëtorëve të huaj. Nuk u vunë re dallime të mëdha për propozimin *"Shqipëria duhet të jetë e hapur të pranojë fuqi të huaj punëtore."*

Si përfundim, një nga mësimet kryesore që doli nga ky ushtrim i parë i anketimit deliberativ në Shqipëri është se informacioni dhe mundësia për të diskutuar dhe shkëmbyer pikëpamje është me rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e opinionëve të bazuara në informacion dhe për arritjen e konsensusit. Edhe pse konsensusi është i vështirë për t'u arritur për tema tejet të polarizuara dhe politizuara në kohë të shkurtër, përfitimet nga diskutimet e bazuara në informacione në periudhën afatmesme dhe afatgjate janë shumë të vlefshme, sepse ndihmojnë në krijimin e një kulture të menduarit kritik.

# HYRJE

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) zhvilloi ushtrimin e parë në rang kombëtar të anketimit deliberativ,<sup>1</sup> që kulmoi me një aktivitet debatues të mbajtur në Tiranë në datat 18-21 nëntor 2021. Në këtë aktivitet u mblodhën 110 qytetarë nga e gjithë Shqipëria për të diskutuar për disa nga çështjet më të nxehta dhe/ose më aktuale në debatin publik dhe politik në vend, të tilla si mbikëqyrja parlamentare, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje, demokracia e brendshme e partive politike, reforma zgjedhore, vota e diasporës, ndryshimet klimatike dhe imigrimi ekonomik.

Grupi prej 110 pjesëmarrësish, që në këtë studim do të quhet “grupi eksperimental”, u zgjodh nga një kampion prej 1200 qytetarësh që morën pjesë në një anketim përfaqësues kombëtar të administruar më parë nga IDM gjatë periudhës 8-18 tetor 2021. Në këtë anketim kombëtar qytetarëve iu bënë një sërë pyetjesh lidhur me temat e mësipërme dhe u testuan qëndrimet e tyre ndaj zgjidhjeve të mundshme. Përveç pjesëmarrësve të grupit eksperimental, që morën pjesë në aktivitetin debatues “Shqipëria n’Kuvendim”, u zgjodhën në mënyrë rastësore edhe 110 qytetarë të tjerë të thjeshtë nga kampioni kombëtar i anketimit dhe që nuk morën pjesë në këtë aktivitet, për të vepruar si “grupi i kontrollit”. Pas përfundimit të aktivitetit “Shqipëria n’Kuvendim”, pjesëmarrësve të të dy grupeve iu kërkua të plotësonin të njëjtin pyetësor që u përdor për anketën kombëtare në fillim të tetorit 2021.

Grupi eksperimental pati mundësinë të diskutonte për temat dhe të merrte informacione shtesë përmes materialeve informuese dhe paneleve të ekspertëve të pavarur gjatë aktivitetit katër-ditor “Shqipëria n’Kuvendim”. Materialet informuese u hartuan nga një grup ekspertësh dhe u shqyrtuan nga Bordi Këshillimor i Anketimit Deliberativ për të siguruar saktësinë dhe objektivitetin e informacionit që do t’u jepej pjesëmarrësve. Pjesëmarrësve

të grupit eksperimental iu dërgua paraprakisht materiali informues për t’i informuar ata për diskutimet që do të bënin në grupe të vogla në lidhje me argumentet pro dhe kundër propozimeve të politikave për secilën temë. Pyetjet që u bënë gjatë këtyre diskutimeve u trajtuan nga ekspertët në seancat plenare. Në fund të procesit, pjesëmarrësit plotësuan të njëjtin pyetësor siç bënë gjatë anketimit kombëtar.

Në këtë raport trajtohet ndryshimi i qëndrimeve që bëhet i mundur nga marrja e informacionit, duke analizuar dallimet në perceptimet mes pjesëmarrësve të anketimit deliberativ dhe pjesëmarrësve të grupit të kontrollit. Së pari, raporti paraqet gjetjet e anketimit kombëtar për një sërë çështjesh për secilën temë të përcaktuar. Më pas, raporti fokusohet në propozime të caktuara politikash për secilën fushë (p.sh. mekanizmat për përmirësimin e mbikëqyrjes parlamentare, pjesëmarrja e qytetarëve ose format e zbatimit të votimit të diasporës etj.) të pyetura në anketim dhe në të shqyrtohen perceptimet dhe qëndrimet e pjesëmarrësve të grupit eksperimental dhe atij të kontrollit. E gjithë kjo mbështetet edhe në një analizë krahasuese të rezultateve të testit-t dhe duke bërë matjen e dallimeve statistikore me qëllim përcaktimin nëse pjesëmarrësit mund të jenë ndikuar nga marrja e informacionit dhe njohurive të reja (grupi eksperimental) ose nga mungesa e tij (grupi i kontrollit).

Ky raport plotësohet nga shtatë raporte tematike, në të cilat jepen perceptimet dhe qëndrimet në nivel kombëtar të qytetarëve (anketimi kombëtar) për secilën nga temat e përcaktuara, si angazhimi i qytetarëve, mbikëqyrja parlamentare, demokracia e brendshme e partive politike, reforma zgjedhore, vota e diasporës, ndryshimet klimatike dhe imigrimi ekonomik. Këto përbëjnë grupin kryesor të njohurive të përfutuara nga ushtrimi i anketimit deliberativ, i cili i shërben projektit PACEP për të informuar aktorët

1 Anketimi i parë deliberativ në Shqipëri u realizua falë bashkëpunimit mes Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Qendrës për Demokraci Deliberative e Universitetit Stanford (SHBA), në kuadër të PACEP, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatuar nga Instituti Kombëtar Demokrat Amerikan (NDI).



kryesorë të Parlamentit për rrugët e mundshme për reforma në secilën nga temat e synuara si dhe

për format e rritjes së angazhimit të qytetarëve në aktivitetet dhe vendimmarrjen e tij.

## ÇFARË ËSHTË ANKETIMI DELIBERATIV?

Iniciuar për herë të parë nga James Fishkin në Qendrën për Demokraci Deliberative të Universitetit të Stanfordit, anketimi deliberativ është një përpjekje për të përdorur hulumtimin e opinionit publik në një formë të re dhe konstruktive. Fishkin dhe kolegët e tij Robert C. Luskin dhe Alice Siu kanë kryer anketime deliberative në 24 vende të botës dhe anketime të tilla janë realizuar mbi 100 herë në plot 29 vende të ndryshme të botës.<sup>2</sup>

Anketimi deliberativ është një formë e veçantë e konsultimit politik ku ndërthuren teknikat e hulumtimit të opinionit publik dhe debatit publik për të zbuluar se çfarë opinionit do të kishte publiku për një çështje të caktuar nëse qytetarëve do t'u jepej një mundësi për t'u informuar më mirë. Anketimi deliberativ tenton të marrë parasysh preferencat dhe opinionet e qytetarëve para dhe pasi këta të fundit të kenë pasur mundësinë për të bërë gjykime të mirëmenduara bazuar në informacione të balancuara dhe pas diskutimeve me bashkëqytetarët e tjerë.



2 Për më shumë informacioni vizitoni <http://cdd.stanford.edu>

# METODOLOGJIA

Ky anketim deliberativ mbështetet në tre anketime –një anketim me përfaqësim kombëtar prej 1,200 të anketuarish, një anketim me një grup eksperimental me 110 pjesëmarrës dhe një anketim me një grup kontrolli me 110 pjesëmarrës të tjerë– ku përdoret i njëjti pyetësor si instrumenti kryesor për mbledhjen e të dhënave. Anketimi kombëtar u realizua para dy anketimeve të tjera dhe u hartua për të nxjerrë në pah perceptimet e publikut në nivel kombëtar. Ai u pasua nga një aktivitet informues katër-ditor “Shqipëria n’Kuvendim”, ku një grupi prej 110 të anketuarish të përzgjedhur në mënyrë rastësore nga kampioni i anketimit kombëtar u dha mundësia për të marrë njohuri dhe informacione nga ekspertët. Në fund të këtij aktiviteti, pjesëmarrësit në këtë ‘grup eksperimental’ iu përgjigjën të njëjtit pyetësor të përdorur më parë në anketimin kombëtar. Paralelisht me anketimin e grupit eksperimental, 110 të anketuar të tjerë të zgjedhur në mënyrë rastësore nga kampioni i anketimit kombëtar iu përgjigjën të njëjtit pyetësor. Në këtë mënyrë formohet ‘grupi i kontrollit’, i cili bën të mundur të analizohet mikrokozmosi i të anketuarve të ngjashëm me grupin eksperimental për qëllime krahasuese.

## ANKETIMI KOMBËTAR

Për anketimin kombëtar u përdor një kampion përfaqësues i popullsisë shqiptare, ku të anketuarit u zgjedhën në mënyrë rastësore nga të gjitha bashkitë dhe njësitë administrative të vendit. Përdorimi i një kampioni të ponderuar përfaqësimi kombëtar na bën të mundur që gjetjet t’i aplikojmë për të gjithë popullsinë në vend. Si rrjedhim, niveli i rëndësisë statistikore të kampionit përshkruhet si

më poshtë: për një popullatë shqiptare rezidente në moshë madhore prej 2,220,569<sup>3</sup>, me një madhësi kampioni prej 1,200 të anketuar, për një nivel besimi 95%, intervali i besimit është  $\pm 2,83$ ; dhe për një nivel besimi prej 99%, intervali i besimit është  $\pm 3,72$ .<sup>4</sup>

Për të përcaktuar madhësinë e kuotës së secilit prej qarqeve të vendit, numri i popullsisë së Shqipërisë u mor nga regjistri civil, ndërsa numri i banorëve për secilin qark në 1 janar 2021 u mor nga Instituti i Statistikave (INSTAT). Duke qenë se numri i banorëve në moshën mbi 18 vjeç ndryshonte me vetëm 0,31% mes viteve 2019 dhe 2021, ky ndryshim nuk ndikoi statistikisht në madhësinë e kampionit sipas qarkut dhe në intervalin e besimit të përmendur më sipër. Kampioni prej 1,200 të anketuarish u shpërnda në të 61 bashkitë e 12 qarqeve të vendit. Më pas, shpërndarja sipas qarkut u përshtat për të zgjedhur vetëm popullsinë në moshë madhore (mbi 18 vjeç) dhe për të përdorur kontrolle kuotash për gjininë. Duke qenë se INSTAT nuk i përcakton grupmoshat nën 18 vjeç ose mbi 18 vjeç, është përdorur teknika e interpolimit linear.

Koeficienti i përfaqësimit të popullatës<sup>5</sup> për meshkujt të moshës mbi 18 vjeç në 1 janar 2019 në Shqipëri u vendos në 0.779325197 dhe për femrat në 0.790087789. Koeficienti i përfaqësimit të të gjithë popullatës për shqiptarët e moshës mbi 18 vjeç ishte 0.78472508614746.<sup>6</sup> Si për ilustrim, në Tabelën 1 jepet shpërndarja sipas qarkut e popullsisë rezidente e moshës mbi 18 vjeç dhe madhësia e kampionit sipas qarkut.

3 Shih Tabelën 1 për hollësi të tjera.

4 Intervali i besueshmërisë (për statistikën e të gjithë popullsisë të vlerësuar në studimin tonë) është një interval vlerash për të cilat mund të jeni (95% / 99%) të sigurt që përmban mesataren e vërtetë të vlerësimeve të parametrave të popullatës. Në rastin tonë ky interval vlerash është intervali i besueshmërisë ( $\theta - 2,83$ ;  $\theta + 2,83$ ) për çdo vlerësim të dhënë  $\theta$ .

5 Koeficienti i përfaqësimit të popullsisë është raporti i totalit të popullatës pas zbritjes së numrit të banorëve të moshës nën 18 vjeç nga totali i popullsisë. E njëjta metodë (për analogji) përdoret edhe për koeficientin në rastin e pjesëtimit sipas gjinisë.

6 Kjo do të thotë se rreth 78.4% e popullsisë në Shqipëri ishin të moshës mbi 18 vjeç në 1 janar 2019.

Tabela 1: Popullsia rezidente në 1 janar 2019 dhe 1 janar 2021 dhe madhësia e kampionit sipas qarkut

QARKU	POPULLSIA REZIDENTE, 2019	POPULLSIA MBI 18 VJEÇ, 2019*)	POPULLSIA MBI 18 VJEÇ, 2021**)	MADHËSIA E KAMPIONIT PËR QARK		
				Meshkuj	Femra	Gjithsej
Berat	125,157	96,788	93,735	25	26	51
Dibër	118,948	91,986	89,210	25	23	48
Durrës	290,126	224,364	229,163	62	62	124
Elbasan	274,982	212,653	208,929	56	57	113
Fier	294,747	227,938	224,433	61	60	121
Gjirokastrë	61,423	47,500	45,538	12	13	25
Korçë	207,889	160,767	158,666	42	43	85
Kukës	76,594	59,233	58,374	16	15	31
Lezhë	125,195	96,817	94,699	25	26	51
Shkodër	202,895	156,905	154,730	41	43	84
Tiranë	895,160	692,257	715,818	190	197	387
Vlorë	189,311	146,400	147,273	40	40	80
<b>Gjithsej</b>	<b>2,862,427</b>	<b>2,213,610</b>	<b>2,220,569</b>	<b>595</b>	<b>605</b>	<b>1,200</b>

Më pas, kjo përzgjedhje u ponderua sipas grupmohave më të fundit të publikuara nga INSTAT (në kohën kur u hodh shorti), që ishin të dhënat për vitin 2020.

Rezultatet e përllogaritura dhe të publikuara në këtë analizë janë ponderuar sipas dy dimensioneve: shpërndarja gjeografike e popullsisë dhe grupmosha.

Të dhënat e anketimit kombëtar i bëjnë të mundur këtë raport të paraqesë dhe analizojë perceptimet dhe qëndrimet e shqiptarëve për alternativat e ndryshme të politikave për secilën nga shtatë temat e përcaktuara – pjesëmarrja e qytetarëve, mbikëqyrja parlamentare, demokracia e brendshme e partive politike, reforma zgjedhore, vota e diasporës, ndryshimet klimatike dhe imigrimi ekonomik.

## ANKETIMI I GRUPIT EKSPERIMENTAL DHE AKTIVITETI 'SHQIPËRIA N'KUVENDIM'

Në anketimin kombëtar qytetarët u pyetën, po ashtu, sa të gatshëm ishin për të marrë pjesë në një aktivitet katër-ditor që do të zhvillohej në Tiranë në datat 18-21 nëntor 2021, bazuar në modelin e anketimit deliberativ që mat opinionin publik për temat e sipërpërmendura para dhe pas aktivitetit. Bazuar në vullnetin e shprehur për të marrë pjesë dhe në detajet e kontaktit që dhanë ata, u rekrutuan gjithsej 10% (120 pjesëmarrës) e pjesëmarrësve nga anketimi kombëtar për aktivitetin e anketimit deliberativ. Me këta të anketuar u vijua komunikimi duke u dhënë hollësi për aktivitetin dy javë para tij me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së tyre. Gjithsej 110 individë, përkatësisht 'grupi eksperimental', morën pjesë në të gjitha ditët e këtij kuvendimi dhe 108 prej tyre plotësuan të njëjtin pyetësor që u përdor në anketimin kombëtar. Gjatë aktivitetit, pjesëmarrësit u ndanë në tetë grupe në numër pothuajse të barabartë, ku secili grup kishte

përfaqësimin më të mirë të mundshëm të individëve sipas grupmoshës, të ardhurave dhe gjinive të ndryshme. Ky aktivitet iu dha atyre mundësinë për të diskutuar, për të rritur njohuritë përmes ndërveprimit me ekspertë dhe për të shprehur mendime e tyre për propozime të ndryshme të trajtuara nga pyetësi i anketimit kombëtar dhe materialet e tjera informuese të përgatitura për ta.

## ANKETIMI I GRUPIT TË KONTROLLIT

Në të njëjtën kohë me aktivitetin katër-ditor (në nëntor 2021), u përzgjedh një tjetër grup me 110 të anketuar nga kampioni i anketimit kombëtar për të krijuar grupin e kontrollit. Ata u përzgjedhën me të njëjta karakteristika të kampionit të grupit eksperimental për sa i përket vendbanimit, shpërndarjes gjinore dhe grupmoshës. U zgjedh i njëjti numër për të arritur të njëjtin nivel përfaqësimi (referojuni përfaqësuesit statistikore), për të shmangur nevojën e mundshme për ponderime si dhe për të shmangur çdo pengesë për krahasimin statistikor mes të dhënave të grupit të "kontrollit" dhe grupit të "eksperimentit". Anketimi i grupit të kontrollit kishte për qëllim të shpjegonte ndryshimet në perceptimin dhe qëndrimet që mund të kishin ndodhur në periudhën kohore të administrimit të anketimeve. (Për më shumë informacion shihni Shtojcën II: Përbërja demografike e grupeve eksperimental dhe kontrollit).

## TESTI-T PËR NDRYSHORET E PAVARURA TË ANKETIMEVE TË GRUPIT EKSPERIMENTAL DHE AI I KONTROLLIT

Për të krahasuar qëndrimet e pjesëmarrësve të grupit eksperimental dhe të kontrollit dhe për të identifikuar dhe matur statistikisht dallimet mes këtyre dy grupeve, në këtë hulumtim u përdor "testi-t për ndryshoret (variablat) e pavarur". Më konkretisht, testi-t përdoret për të përcaktuar nëse ka evidenca statistikore që vlerat mesatare të kampionit shoqëruar janë dukshëm të ndryshme apo jo.

Kjo analizë kryhet vetëm për njëzetë variabla të tillë në pyetësor – pohimet apo masat e propozuara – dhe vetëm për të dhënat nga anketimi me pjesëmarrësit e grupit eksperimental dhe të kontrollit. Pohimet përmbajnë propozime dhe/ose masa të caktuara që trajtojnë çështjet e tematikave të përcaktuara (reforma zgjedhore, demokracia e partive, ndryshimet klimatike, etj.). Anketimet e grupit eksperimental dhe të kontrollit kanë si qëllim të analizojnë se si ndryshojnë qëndrimet dhe mbështetja e të anketuarve nëse marrin informacione objektive duke marrë pjesë në aktivitetin katër-ditor 'Shqipëria n'Kuvendim' (grupi eksperimental) ose duke mos marrë pjesë në të (grupi i kontrollit).

# GJETJET E USHTRIMIT TË PARË NË SHQIPËRI TË ANKETIMIT DELIBERATIV

## 01 ANGAZHIMI QYTETAR NË VEPRIMTARINË PARLAMENTARE

Angazhimi qytetar dhe konsultimi publik janë promotorë mjaft të rëndësishëm të proceseve të vendimmarrjes dhe besimit tek institucionet publike. Niveli i ulët i pjesëmarrjes qytetare dhe mungesa e besimit të publikut tek institucionet bëhen pengesë për transparencën dhe efikasitetin e politikave, ndërkohë që dekurajojnë angazhimin qytetar në vendimmarrje.

Në vitin 2020 pati një rënie të konsiderueshme të interesit të publikut për të marrë pjesë në vendimmarrje, nga 57% në 2019 në 47%. Pjesa më e madhe e shqiptarëve mendonin se nuk kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike.<sup>7</sup> Gjithsesi, parë në aspektin optimist, Anketimi i Angazhimit Politik në Shqipëri, i realizuar nga IDM, konstatoi se, pavarësisht rënies së nivelit të angazhimit qytetar, shqiptarët tregohen më shumë të gatshëm të veprojnë për çështje që kanë rëndësi për ta.<sup>8</sup>

Referendumi është një nga instrumentet më të rëndësishme nëpërmjet të cilit qytetarët mund të ushtrojnë drejtpërsëdrejti vullnetin e tyre. Megjithatë, gjatë tre dekadave të fundit në Shqipëri janë mbajtur vetëm tre referendume. Neni 150 i Kushtetutës parashikon miratimin e një ligji të ri për referendumet, por një ligj i tillë ende mungon.<sup>9</sup> Që në vitin 2020 është depozituar në Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore një projektligj për referendumet, i përgatitur nga organizatat e shoqërisë civile dhe i mbështetur nga një deputet,

projektligj që duhet të nxisë një angazhim më të madh. Një instrument tjetër kushtetues për angazhimin e qytetarëve është nisma legislative e qytetarëve. Ky dhe forume të tjera për pjesëmarrjen qytetare mund të ndryshojnë edhe tendencat e angazhimit të dobët dhe mungesës së besimit nga publiku.

### GJETJET E ANKETIMIT KOMBËTAR

Të dhënat e anketimit kombëtar për këtë raport konfirmojnë zhgënjimin e qytetarëve me politikën në përgjithësi. Shqiptarët priren të mos jenë dakord me pohimin *"Deputetët dhe politikanët i kushtojnë shumë vëmendje mendimit të njerëzve të zakonshëm"* (N=1193). Në një shkallë nga 0 (aspak dakord), në 10 (plotësisht dakord), mesatarja është 2.31 dhe devijimi standard<sup>10</sup> është 2.91. Po ashtu, rezultatet e anketimit kombëtar tregojnë përqindje mjaft më të larta të kundërshtimit ndaj pohimit *"Njerëzit e zakonshëm kanë ndikim në punën e Parlamentit"* (N=1194). Në të njëjtën shkallë, mesatarja këtu është 2.62 dhe një devijim standard prej 2.98.

Të pyetur *"Sa besim keni se Parlamenti në përgjithësi bën atë që është e drejtë (gjënë e duhur)?"* shumica e të anketuarve thanë 'aspak' (40%) ose 'pak' (29.2%). Më pak se një e treta e tyre kishin 'shumë' (6.7%) apo 'jashtëzakonisht shumë' (1.3%) besim se Parlamenti në përgjithësi bën atë që është e drejtë (shih Figurën 3).


7 IDM, Besimi në qeverisje 2020, gjendet në: <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/IDM-OpinionPoll-2019-AL-web-1.pdf>

8 IDM, Gjetjet e anketimit të angazhim politik në Shqipëri 2020, gjendet në: <https://idmalbania.org/survey-of-political-engagement-in-albania-2020/>

9 Shih Nenin 150, Kushtetuta e Shqipërisë, gjendet në: <https://www.parlament.al/Kuvendi/Kushtetuta>.

10 Në vijim mund të përdoret shkurtimi DS.


**FIGURA 3: SA BESIM KENI SE PARLAMENTI NË PËRGJITHËSI BËN ATË QË ËSHTË E DREJTË (GJËNË E DUHUR)? (N=1192)**



Të anketuarit ishin të ndarë kur u pyetën se sa kuptojnë personalisht nga ajo që po ndodh në politikë dhe Parlament. Një e katërta e tyre (24.6%) thanë se kuptonin 'jashtëzakonisht shumë' (4.4%) apo 'shumë' (20.2%); pothuajse 1/3 e të anketuarve

raportuan 'pak' (29%) ose 'aspak' (5.4%); dhe një tjetër përqindje 40.7% mendonin se kuptonin pjesërisht atë që po ndodhte në politikë dhe Parlament (shih Figurën 4).

**FIGURA 4: SA KUPTONI JU PERSONALISHT NGA AJO QË NDODH NË POLITIKË DHE PARLAMENT? (%) (N= 1196)**




Tendenca e mësipërme vihet re edhe në nivelin e dakordësisë me pohimin, “Shumë çështje të politikave publike dhe ligjeve janë aq të ndërlikuara saqë njerëzit e zakonshëm e kanë të vështirë të kuptojnë se ç’po ndodh” (N=1183). Në një shkallë nga 0 (aspak dakord) deri në 10 (plotësisht dakord) përgjigjet mbizotëruese qëndrojnë në mes të këtij boshti. Më konkretisht, të dhënat e anketimit kombëtar sugjerojnë një mesatare prej 6.81 dhe devijim standard prej 3.18 për këtë pohim.

Megjithatë, pavarësisht aftësive të njerëzve për të kuptuar veprimtarinë parlamentare apo politikën në përgjithësi, të anketuarit nuk kishin dyshim se konsultimi me qytetarët dhe grupet e interesit do të përmirësonte punën e Kuvendit. Të anketuarit

(N=1186) treguan një nivel relativisht të lartë dakordësie për propozimin “Konsultimi me qytetarët dhe grupet e interesit të bëhet i detyrueshëm për të gjitha projektligjet, pavarësisht kostove dhe kohës së nevojshme” si instrument për përmirësimin e punës dhe performancës së parlamentit. Në një shkallë nga 0 (e kundërshtoj tërësisht) deri në 10 (e mbështes plotësisht), shqiptarët e vlerësuan këtë masë me mesataren 7.86 dhe devijim standard prej 2.41.

Të dhënat tregojnë se shqiptarët nuk kanë informacion të mjaftueshëm as për instrumentet, as për format e pjesëmarrjes politike për të ndikuar në veprimtarinë e Kuvendit (shih Figurën 5).

**FIGURA 5: SIPAS RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË KUVENDIT, A MUND TË MERRNI PJESË JU SI QYTETAR NË MBLEDHJET E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME PARLAMENTARE? (N= 689)**




Vetëm një në dhjetë të anketuar ishin të informuar se sipas rregullores së Kuvendit mund të merrnin pjesë në mbledhjet e komisioneve të përherëshme duke paraqitur një kërkesë të thjeshtë para fillimit të mbledhjes. Pothuajse 90% e të anketuarve thanë se ose nuk e dinin (43.9%) se mund të merrnin pjesë në takime të tilla ose kishin marrë informacion të pasaktë nëse e kishin mundësi dhe si mund të ndiqnin mbledhjet e komisioneve parlamentare.

Më pak se një e pesta e të anketuarve në anketimin kombëtar zgjodhën përgjigjen e duhur kur u pyetën të identifikonin se cilat forma ligjore për pjesëmarrjen e qytetarëve nuk ishin vendosur ende me ligj. Pra, vetëm 18.1% kanë identifikuar saktë se aktualisht nuk ka asnjë ligj të miratuar për

referendumet në Shqipëri. Mbi 80% e shqiptarëve ose nuk e dinin fare (47.9%) ose kishin informacion të pasaktë për mungesën e një ligji të miratuar posaçërisht për nisma të tjera angazhimi.

Edhe pse përgjithësisht të paqartë për ekzistencën apo hartimin e një ligji për referendumet dhe nismat ligjore qytetare, shqiptarët do të parapëlqenin një ligj të përbashkët për të dy llojet e instrumenteve. Në një shkallë nga 0 (e mbështes plotësisht), to 10 (e kundërshtoj tërësisht), të anketuarit nga anketimi kombëtar (N=1163) ishin në përgjithësi në favor (me një mesatare prej 7.84) të propozimit “Miratimi i një ligji të unifikuar për referendumet dhe nismat ligjore qytetare”.

FIGURA 6: SHQIPËRI NUK KA MIRATUAR LIGJ PËR ... (%) (N=638)



Në këtë anketim kombëtar të anketuarit dhanë vlerësimin e tyre nga 0 (aspak dakord), dhe 10 (plotësisht dakord) – për disa propozime që kanë të bëjnë me përmirësimin e angazhimit qytetar në veprimtarinë e Kuvendit. Në përgjithësi, të anketuarit

shfaqën një nivel relativisht të lartë mbështetjeje për masat e propozuara që synojnë forcimin e angazhimit të qytetarëve në vendimmarrje. Në Tabelën 2 jepen rezultatet nga anketimi kombëtar për secilin pohim.

Tabela 2: Mbështetja për masat e propozuara për angazhimin qytetar në vendimmarrjen parlamentare (anketimi kombëtar)

MASA E PROPOZUAR	N		MESATARJA	DEVIJIMI STD.	MIN.	MAKS.
	VLERAT E VLEFSHME	VLERAT QË MUNGOJNË				
Parashikimi i një buxheti (fonde publike) të veçantë për të mbuluar kostot e nisjes së një referendumi apo nismës ligjore qytetare	1169	31	6.84	2.828	0	10
Vendosja e detyrimit për të organizuar referendume për çështje të rëndësishme	1177	23	7.67	2.526	0	10
T’u mundësohet zgjedhësve që të nënshkruajnë peticione online dhe të detyrojnë parlamentin të diskutojë për çështje të rëndësishme për publikun	1180	20	7.82	2.510	0	10

Shënim: shkalla nga 0 – aspak dakord; to 10 – plotësisht dakord.




Në pjesën e mëposhtme analizohet mbështetja për të njëjtat propozime nga pjesëmarrësit e anketimit deliberativ, që kishin marrë informacione dhe kanë dëgjuar ekspertët për propozimet (të anketuarit nga grupi eksperimental), dhe ata që nuk morën informacione të tilla (të anketuarit nga grupi i kontrollit) dhe dallimet mes tyre.

### GRUPI EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT

Nga analiza krahasuese e të dhënave të anketimeve me grupin eksperimental dhe grupin e kontrollit dalin në pah dallime mes pikëpamjeve dhe perceptimeve të pjesëmarrësve në ushtrimin deliberativ për të tre masat e propozuara për përmirësimin e pjesëmarrjes së qytetarëve. Rezultatet sugjerojnë se grupi që mori pjesë në aktivitetin debatues dhe u informua përmes materialeve informuese dhe diskutimeve me panele ekspertësh tregoi një nivel më të lartë dakordësie me propozimet në krahasim me grupin e kontrollit.

FIGURA 7: MESATARJA PËR PROPOZIMET PËR PJESËMARRJEN E QYTETARËVE - GRUPI EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT



*“Parashikimi i një buxheti (fonde publike) të veçantë për të mbuluar kostot e nisjes së një referendumi apo nismës ligjore qytetare”*

Pati një rritje të konsiderueshme të mbështetjes për këtë propozim mes pjesëmarrësve të grupit eksperimental krahasuar me të anketuarit nga grupi i kontrollit. Në mënyrë të veçantë, grupi eksperimental kishte vlerë mesatare më të lartë (8.32) dhe devijim standard (2.51) sesa grupi i kontrollit (vlera mesatare 7.11 dhe DS 2.38). Testi-t konfirmon dallimet mes dy grupeve, ku grupi eksperimental kishte një vlerë më të lartë se grupi i kontrollit.

*“Vendosja e detyrimit për të organizuar referendume për çështje të rëndësishme”*

Gjatë aktivitetit katër-ditor u analizuan të gjitha aspektet e organizimit të referendumeve. Grupi i eksperimental shfaqti një nivel më të lartë dakordësie për këtë propozim krahasuar me grupin e kontrollit, ku grupi eksperimental kishte një vlerë mesatare prej 8.43 dhe DS 2.51, ndërkohë që vlera e grupit të

kontrollit ishte 7.67 dhe DS 2.06. Testi-t evidentoi se ka dallime mes dy grupeve, ku grupi eksperimental kishte një vlerë mesatare më të lartë se grupi i kontrollit.

*“T’u mundësohet zgjedhësve që të nënshkruajnë peticione online dhe të detyrojnë parlamentin të diskutojë për çështje të rëndësishme për publikun”*

Së fundi, ky propozim pati nivele më të larta dakordësie nga pjesëmarrësit e eksperimentit. Duke pasur parasysh përdorimin e pjesëmarrjes elektronike, ky propozim përbën një tjetër instrument që mund të përdoret për rritjen e angazhimit të qytetarëve. Në këtë rast, grupi eksperimental kishte një vlerë mesatare prej 9.08 dhe DS 1.94, ndërsa grupi i kontrollit kishte një vlerë mesatare prej 7.65 dhe DS 2.58. Edhe një herë u konfirmuan dallimet mes dy grupeve, pasi grupi eksperimental shfaqti nivele më të larta mbështetjeje në krahasim me grupin e kontrollit.

Mbikëqyrja parlamentare është një nga aspektet më prioritare për përmirësimin e performancës së Kuvendit të Shqipërisë dhe raportet vjetore të Komisionit Evropian (KE) për vendin kanë kërkuar vazhdimisht që kjo performancë të forcohet dhe përmirësohet.<sup>11</sup> Kriza politike e vitit 2019 dhe dalja e opozitës parlamentare nga korniza institucionale vetëm sa nxorën në pah edhe më shumë dobësitë e pushtetit legjislativ në mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe të mekanizmave të dobët të kontrollit dhe balancës. Parlamenti dhe qeveria shqiptare drejtohen nga një parti politike dhe një kryetar partie, roli i të cilit u forcua ndjeshëm me ndryshimet kushtetuese të vitit 2008.<sup>12</sup>


Disa institucione të pavarura si Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), Avokati i Popullit e të tjerë të cilët kanë për detyrë të bëjnë që institucionet shtetërore dhe proceset e drejtuara nga qeveria të japin llogari dhe të kontrollojnë proceset e drejtuara prej këtyre të fundit. Pavarësia e tyre është e një rëndësie të

jashtëzakonshme duke pasur parasysh rolin që kanë në sistemin e kontrollit dhe balancës.

### GJETJET E ANKETIMIT KOMBËTAR

Shqiptarët nuk janë ende të familjarizuar me instrumentet e mbikëqyrjes parlamentare mbi ekzekutivin. Kur u pyetën sa njohuri kanë për rolin kontrollues dhe mbikëqyrës të Parlamentit mbi qeverinë, shumica e të anketuarve në anketimin kombëtar raportuan se kishin “pak” (35,7%) ose “aspak” (20,4%) njohuri. Një tjetër 33% e të anketuarve raportuan njohuri mesatare për funksionin mbikëqyrës të Parlamentit.

FIGURA 8: SA NJOHURI KENI PËR ROLIN KONTROLLUES DHE MBIKËQYRËS TË PARLAMENTIT MBI QEVERINË? (%) (ANKETIMI KOMBËTAR) N= 1156



11 Shih Raporti për Shqipërinë i Drejtorisë së Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit të Komisionit Evropian, 19 tetor 2021, f. 15, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en).

12 Ndryshimet kushtetuese të vitit 2008 kanë forcuar në mënyrë të veçantë rolin e kryeministrit dhe kryetarit të partisë. Në atë kohë këto ndryshime justifikoheshin si një mënyrë për të promovuar stabilitetin politik dhe për të shmangur krizat e panevojshme politike.

Edhe pse shumica e tyre nuk kanë njohuri për të, mbikëqyrja parlamentare u vlerësua si shumë e rëndësishme nga të anketuarit. Në një shkallë nga 0 (Jashtëzakonisht e parëndësishme) në 10 (Jashtëzakonisht e rëndësishme), të anketuarve iu kërkua të jepnin një vlerësim për kontrollin dhe mbikëqyrjen parlamentare të qeverisë në përgjithësi. Të dhënat e anketimit kombëtar evidentuan se shqiptarët (N= 1176) e vlerësojnë mbikëqyrjen parlamentare mbi qeverinë si shumë të rëndësishme me një mesatare prej 7.84 dhe DS prej 2.50. Megjithatë, ku u pyetën për efektivitetin në

praktikë të mbikëqyrjes parlamentare mbi qeverinë, vlerësimi i të anketuarve ishte disi pesimist. Në një shkallë nga 0 në 10, 0 (Jashtëzakonisht jo efektiv) në 10 (Jashtëzakonisht efektiv), të anketuarit dhanë një vlerësim mesatar prej 3.85 dhe DS prej 2.92.

Të anketuarve të anketimit kombëtar iu kërkua të vlerësonin në një shkallë nga 0 (e kundërshtoj tërësisht) në 10 (e mbështes plotësisht) preferencat dhe mbështetjen e tyre për disa masa për përmirësimin e demokracisë në Shqipëri. (Shih Tabelën 3).

**Tabela 3: Mbështetja për masat e propozuara për forcimin e mbikëqyrjes parlamentare**

MASA E PROPOZUAR	N		MESATARJA	DEVIJIMI STD.	MIN.	MAKS.
	VLERAT E VLEFSHME	VLERAT QË MUNGOJNË				
T'i mundësohet opozitës që të kryesojë të paktën 1/3 e komisioneve parlamentare	1143	57	6.45	2.997	0	10
T'i mundësohen opozitës më shumë burime njerëzore për të ushtruar kontrollin dhe mbikëqyrjen e qeverisë.	1171	29	6.08	3.085	0	10
Krerët e institucioneve të pavarura (të cilët ndihmojnë kontrollin dhe llogaridhënien e ekzekutivit) të zgjidhen me shumicë të cilësuar (2/3) e votave në Parlament.	1157	43	7.83	2.487	0	10

*Shënim: shkalla nga 0 - e kundërshtoj tërësisht; 10 - e mbështes plotësisht*

Siç tregojnë edhe të dhënat e mësipërme, shqiptarët priren të shfaqin më shumë mbështetje për propozimin e tretë, i cili mbështetet në rolin e institucioneve të pavarura mbikëqyrëse, sesa për masat që kanë të bëjnë me opozitën parlamentare. Kjo sugjeron një orientim drejt një roli më të madh të institucioneve të pavarura për forcimin e mbikëqyrjes mbi qeverinë. Kjo konfirmohet edhe nga mbështetja për pohimin: "Të rriten dhe

forcohen kompetencat e institucioneve të pavarura (p.sh. KLSH, Avokati i Popullit etj.) në kontrollin ndaj qeverisë, përfshirë edhe kompetenca ndëshkuese (p.sh. gjyqësori) u vlerësua me një mesatare më të lartë prej 8.55 dhe DS 2.21.

Puna e dobët e opozitës në përgjithësi gjatë këtyre viteve të fundit, siç konfirmohet edhe nga burime të tjera,<sup>13</sup> mund të shpjegojë këtë


13 Anketimi më i fundit i realizuar nga IDM për besimin në qeverisje konstatoi se opozita konsiderohej si më pak e gatshme për t'i kërkuar llogari qeverisë, krahasuar me një vit më parë. Shih "Besimi në qeverisje 2020", fq. 52, gjendet në: <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/IDM-OpinionPoll-2019-AL-web-1.pdf>

qëndrim mes shqiptarëve. Anketimi i IDM-së për Angazhimin Politik në Shqipëri konstatoi se 71% e shqiptarëve ishin të pakënaqur nga puna e opozitës parlamentare.<sup>14</sup>

## GRUPI EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT

Nga analiza krahasuese e të dhënave të anketimeve me grupet eksperimental dhe të kontrollit vihet re se perceptimet dhe qëndrimet e të anketuarve të grupit eksperimental ndryshojnë nga ato të pjesëmarrësve që nuk kishin marrë informacione (grupi i kontrollit). Ky konstatim vlen për dy nga tre propozimet që lidhen me forcimin e mbikëqyrjes parlamentare dhe demokracisë në Shqipëri.

FIGURA 9: MESATARJA PËR FORCIMIN E MBIKËQYRJES PARLAMENTARE - GRUPI EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT



*“Ti mundësohet opozitës që të kryesojë të paktën 1/3 e komisioneve parlamentare.”*

Në një shkallë nga 0 (e kundërshtoj tërësisht) në 10 (e mbështes plotësisht), grupi eksperimental kishte një mesatare prej 6.1 dhe një DS prej 2.97. Testi-t evidenton dallime të mëdha, duke qenë se grupi eksperimental kishte vlerë mesatare më të lartë se të anketuarit nga grupi i kontrollit. Kjo do të thotë se rritja e informacionit dhe njohurive ndihmoi që

pjesëmarrësit e grupit eksperimental të kapërcenin skepticizmin e tyre të madh për opozitën pas analizimit të këtij propozimi të veçantë, duke e parë këtë masë si më të rëndësishme në krahasim me pjesëmarrësit e grupit të kontrollit.

*“Ti mundësohen opozitës më shumë burime njerëzore për të ushtruar kontrollin dhe mbikëqyrjen e qeverisë.”*

14 IDM, Gjetjet e anketimit të angazhim politik në Shqipëri 2020, gjendet në: <https://idmalbania.org/survey-of-political-engagement-in-albania-2020/>

Duke përdorur të njëjtën shkallë, grupi eksperimental dhe grupi i kontrollit nuk shfaqën dallime në lidhje me këtë pohim. Grupi eksperimental kishte një mesatare prej 6.27 dhe DS 3.37, kurse për grupin e kontrollit këto vlera ishin 6.21 dhe 2.79 për DS. Rezultatet tregojnë se marrja e njohurive të reja dhe dialogu i informuar me anëtarët e tjerë të grupit dhe me ekspertët nuk kishin pasur ndikim të madh në qëndrimin e pjesëmarrësve të grupit eksperimental.

*“Krerët e institucioneve të pavarura të zgjidhen me shumicë të cilësuar (2/3) e votave në Parlament.”*


Niveli i mbështetjes për këtë propozim u rrit për grupin eksperimental, i cili kishte marrë më shumë njohuri dhe informacione në aktivitetin katërditor të muajit nëntor 2021. Në mënyrë të veçantë, grupi eksperimental shfaqti një mesatare prej 8.24 dhe DS prej 2,05 ndërsa grupi i kontrollit një mesatare prej 7.42 dhe DS prej 2.38. Testi-t evidentoi dallime të mëdha mes dy grupeve.

## 03 DEMOKRACIA E BRENDSHME E PARTIVE POLITIKE

Demokracia e brendshme e partive politike në Shqipëri ka qenë shqetësim tepër i madh në tre dekadat e fundit. Disa nisma dhe programe të donatorëve të huaj kanë dhënë ndihmë në përpjekje për të demokratizuar partitë politike në Shqipëri. Progresi i kufizuar në këtë drejtim evidenton për sfidat që dalin përpara dhe për rezistencën që tregohet nga aktorët politikë. Pjesa më e madhe e

shqiptarëve janë të pakënaqur me demokracinë shqiptare, të cilës raporti "Kombet në Tranzit" i Freedom House i referohet si "regjim hibrid apo në tranzicion".<sup>15</sup> Rreth 60% të anketuarve të anketimit kombëtar thanë se janë 'pak' ose 'aspak' të kënaqur me mënyrën se si funksionon demokracia në Shqipëri (shih Figurën 10).

FIGURA 10: NË PËRGJITHËSI, SA I/E KËNAQUR JENI ME MËNYRËN SI FUNKSIONON DEMOKRACIA NË SHQIPËRI? (%) (ANKETIMI KOMBËTAR, N=1193)



Roli i partive politike në demokracinë liberale është i pamohueshëm dhe partitë politike cilësohen si të rëndësishme për cilësinë e qeverisjes nga pjesa më e madhe e shqiptarëve. Nga të dhënat e anketimit kombëtar (N=1195) konstatohet se, në një shkallë nga 0 (jashtëzakonisht i parëndësishëm) në 10 (jashtëzakonisht i rëndësishëm), shqiptarët e vlerësojnë rolin e partive politike në cilësinë e qeverisjes me një mesatare prej 7.00 dhe devijim standard prej 2.99. Pritshmëri të tilla nënkuptojnë se partitë politike duhet të qeverisen në përputhje me vlerat demokratike.

Pothuajse të gjitha partitë politike në Shqipëri mbështeten në statutet dhe rregulloret e miratuara,

të cilat janë përfshirë në dokumentet e tyre zyrtare. Sipas statuteve të tyre, partitë politike shpesh pretendojnë se garantojnë respektimin e kritikave; se mundësojnë vendimmarrje të bazuar vetëm në votim; se pranojnë ide të reja dhe të ndryshme; se nxisin kandidimin për poste drejtuese; dhe se lejojnë anëtarësimin dhe largimin e lirë nga partia. Megjithatë, në praktikë, këto nuk rezultojnë gjithmonë kështu. Mosrespektimi i këtyre parimeve vihet re në numrin e lartë të partive politike që kanë lindur nga dy partitë kryesore: Partia Socialiste (PS) dhe Partia Demokratike (PD). Që nga rënia e komunizmit, janë krijuar 15 parti të reja si efekt anësor i sanksioneve, kufizimeve dhe përjashtimeve të anëtarëve brenda PS dhe PD.


15 Shih Raportin e Freedom House "Kombet në Tranzit" Albania në <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2021>.

Ligji për partitë politike në Shqipëri i ka filluar më shumë se dy dekada më parë (shkurt 2000) dhe ndonëse i janë bërë disa herë ndryshime nga Parlamenti dhe nga një vendim i Gjykatës Kushtetuese, ligji nuk ka adresuar shqetësimet kryesore për funksionimin e demokracisë së brendshme, anëtarësimin, transparencën, financimet, etj. Sfidat e vazhdueshme njihen gjerësisht nga anëtarësia e partive, ndërkohë që qytetarët në përgjithësi i konsiderojnë partitë politike si institucionet më pak të besueshme në Shqipëri.<sup>16</sup> Prandaj, forcimi i demokracisë së brendshme i partive është i një rëndësie tejet të madhe.

## GJETJET E ANKETIMIT KOMBËTAR

Nga anketimi kombëtar (N=1196) konstatohet se pjesa më e madhe e të anketuarve janë “mesatarisht” (39%) ose “pak” (31%) të interesuar për politikën, ndërkohë që 15.8% nuk janë “aspak” të interesuar. Vetëm 10.8% e të anketuarve tregojnë se janë “shumë të interesuar” dhe 2.2% “jashtëzakonisht të interesuar” për politikën. Megjithatë, një mungesë e mirëfilltë interesi nuk reflektohet në pjesëmarrjen në zgjedhjet parlamentare. Siç sugjerohet edhe në Figurën 11, tre nga katër të anketuar konfirmojnë se kanë votuar në zgjedhjet e fundit parlamentare në Shqipëri më 25 prill 2021.

FIGURA 11: A VOTUAT NË ZGJEDHJET E FUNDIT PARLAMENTARE? (%) (ANKETIMI KOMBËTAR, N = 1091)




Gjithashtu, të anketuarit e anketimit kombëtar nuk kishin shumë njohuri për organizimin e brendshëm të partive politike, duke qenë se shumica e tyre kishin “pak” (40%) ose “aspak” (17.9%) njohuri për këtë temë. Më pak se 7% e shqiptarëve pretendojnë se kanë “shumë” (6.2%) ose “jashtëzakonisht shumë” (0.7%) njohuri organizimin e brendshëm të partive politike (shih Figurën 12).

16 Shih raportet vjetore të IDM ‘Besimi në qeverisje’ 2015–2020, gjenden në <https://idmalbania.org/trust-in-governance/>.



**FIGURA 12: NË PËRGJITHËSI, SA NJOHURI KENI PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË PARTIVE POLITIKE NË SHQIPËRI? (%) (ANKETIMI KOMBËTAR, N = 1182)**



Për të trajtuar një mungesë të tillë informacioni dhe për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për partitë politike, për strukturat e tyre qeverisëse dhe demokracinë e brendshme, më shumë se gjysma e shqiptarëve të anketuar (53%) e vlerësojnë publikimin online të statuteve të partive politike me 9+, në një shkallë nga 0 (jashtëzakonisht e parëndësishme) në 10 (jashtëzakonisht e rëndësishme). Sipas të dhënave të anketimit kombëtar, pohimi "Të bëhen publike online statutet

dhe strukturat e brendshme të partive politike" (N = 1192) kishte një vlerë mesatare prej 7.8 dhe devijim standard prej 2.54.

Në përgjithësi, të anketuarit e anketimit kombëtar treguan një nivel relativisht të lartë dakordësie për dy nga tre masat e propozuara që synojnë përmirësimin e demokracisë së brendshme të partive politike.

**Tabela 4: Niveli i dakordësisë për masat që synojnë llogaridhënien dhe demokracinë e brendshme të partive politike (Anketimi kombëtar)**

MASA E PROPOZUAR	N		MESATARJA	DEVIJIMI STD.	MIN.	MAKS.
	VLERAT E VLEFSHME	VLERAT QË MUNGOJNË				
Të vendosen mekanizma konkurrimi brenda partive politike (p.sh., primaret e kandidatëve për zgjedhjet vendore dhe kombëtare).	1184	16	7.93	2.317	0	10
Të rritet financimi publik për partitë dhe kandidatët.	1181	19	3.96	3.395	0	10
Të certifikohen financat e partive politike nga kompani ndërkombëtare.	1173	27	6.89	3.127	0	10

Shënim: shkalla nga 0 në 10 (0 – Jashtëzakonisht të parëndësishme; 10 – Jashtëzakonisht të rëndësishme)


## GRUPI EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT

Nga testi-t që u aplikua tek të dhënat e anketimit për grupin eksperimental dhe të kontrollit u konfirmuan dallime të mëdha për të tre pohimet në lidhje me masat për përmirësimin e llogaridhënies dhe demokracisë së brendshme të partive politike në

Shqipëri. Kjo do të thotë se, në varësi të faktit nëse pjesëmarrësit marrin informacione për avantazhet dhe disavantazhet e secilit propozim, qëndrimet e tyre prirën të jenë në favor të masës përkatëse.

Figura 13: Mesatarja për propozimet për demokracinë e brendshme të partive politike - Grupi eksperimental krahasuar me grupin e kontrollit.

FIGURA 13: MESATARJA PËR PROPOZIMET PËR DEMOKRACINË E BRENDSHME TË PARTIVE POLITIKE - GRUPI EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT



*“Të vendosen mekanizma konkurrimi brenda partive politike (p.sh., primaret e kandidatëve për zgjedhjet vendore dhe kombëtare).”*

Grupi eksperimental ka një vlerë mesatare më të lartë (mesatarja = 8.64 dhe DS = 2.20) në krahasim me grupin e kontrollit (mesatarja = 7.65 dhe DS = 2.23) për këtë propozim. Testi-t zbuloi se ka dallime të mëdha mes dy grupeve. Kjo do të thotë

se pjesëmarrësit e grupit eksperimental, të cilët ishin të informuar mbi avantazhet dhe dobësitë e kësaj mase dhe që morën pjesë në diskutime me kolegët e tyre në aktivitetin katër-ditor, prireshin ta konsideronin këtë masë si të rëndësishme për përmirësimin e llogaridhënies dhe demokracisë së brendshme të partive politike sesa të anketuarit, të cilët nuk i kishin marrë këto njohuri (grupi i kontrollit).

### *“Të rritet financimi publik për partitë dhe kandidatët.”*


Ndryshe nga propozimi i mësipërm, pasi u informuan për temën, pjesëmarrësit e grupit eksperimental treguan nivel më të ulët dakordësie për pohimin “Të rritet financimi publik për partitë dhe kandidatët” si masë për përmirësimin e llogaridhënies dhe demokracisë së brendshme të partive politike. Konkretisht, grupi eksperimental kishte një vlerë mesatare prej 3.40 dhe një DS prej 3.43. Grupi i kontrollit kishte një vlerë mesatare prej 5.57 dhe DS 3.21. Testi-t evidentoi dallime të mëdha mes dy grupeve, pasi grupi eksperimental kishte vlerë mesatare më të ulët se grupi i kontrollit. Kjo do të thotë se pjesëmarrësit e grupit eksperimental e konsiderojnë këtë masë si më pak të rëndësishme për përmirësimin e llogaridhënies dhe demokracisë së brendshme të partive politike në krahasim me pjesëmarrësit e grupit të kontrollit.

### *“Të certifikohen financat e partive politike nga kompani ndërkombëtare.”*

Testi-t konfirmon dallime mes dy grupeve edhe në lidhje me këtë masë të fundit të propozuar. Grupi eksperimental ka një mesatare më të ulët (6.20) dhe DS (3.52) krahasuar me grupin e kontrollit (mesatarja = 7.10 dhe DS = 2.78). Kjo do të thotë se pjesëmarrësit që ishin të informuar për të avantazhet dhe disavantazhet e kësaj mase prireshin ta konsideronin këtë masë si më pak të rëndësishme për përmirësimin e llogaridhënies dhe demokracisë së partive politike sesa pjesëmarrësit pa njohuri dhe informacione të tilla.

Ndonëse pjesëmarrësit në këtë eksperiment social treguan më pak mbështetje për masën e propozuar pasi kishin marrë më shumë informacione rreth asaj mase, anketimi kombëtar nxjerr në pah gjetje interesante në lidhje me njohuritë e shqiptarëve për institucionin përgjegjës për monitorimin e financave të partive politike. Siç sugjerohet në Figurën 14, vetëm 35.8% e shqiptarëve identifikuan institucionin e duhur (Komisionin Qendror të Zgjedhjeve) si organi përgjegjës për kontrollin e financave të partive.

**FIGURA 14: SIPAS LIGJIT PËR PARTITË POLITIKE, CILI ËSHTË ORGANI PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN DHE MBIKËQYRJEN E FINANCIMIT TË PARTIVE? (%) (N=908)**



Sistemi zgjedhor është një shtyllat kryesore të sistemit politik të çdo vendi. Ai përkthen preferencat individuale politike të votuesve në një zgjedhje të vetme në një parlament i cili përfaqëson të gjithë vendin. Sistemi zgjedhor përcakton çështje thelbësore të tilla si kriteri i përfaqësimit; madhësia e parlamentit; madhësia e zonave zgjedhore; sistemi i votimit; kush mund të zgjidhet dhe rregullat e tjera të konkurrimit politik. Duke pasur parasysh këto, reformat zgjedhore duhet të hartohen dhe zbatohen me kujdes të madh. Shqipëria ka bërë tetë reforma zgjedhore që nga rënia e sistemit komunist. Thuajse të gjitha reformat janë bërë me ngut brenda një kohe të shkurtër, pa transparencë dhe pa përfshirje publike.

Shqipëria i ka provuar të tre llojet e sistemeve zgjedhore në tre dekadat e fundit – mazhoritar, proporcional dhe i përzier. Në fillim të periudhës post-komuniste (1991) sistemi zgjedhor ka qenë mazhoritar. Vendi ishte i ndarë në 140 zona elektorale dhe në çdo zonë votuesit zgjidhnin një përfaqësues duke votuar për një nga disa kandidatët për deputetë. Nga vitit 1992 deri në vitin 2008, Shqipëria ka pasur sistem të përzier, 100 deputetë zgjidheshin direkt përmes votimit mazhoritar në 100 zona zgjedhore, ndërsa 40 deputetë të tjera zgjidheshin përmes votimit të partive politike. Nga vitit 2009, zgjedhjet janë zhvilluar me sistem proporcional, ku votuesit votojnë partitë politike ndërsa emrat e deputetëve vendosen nga partitë përmes listave të kandidatëve.


Një nga elementët kryesorë të çdo raporti monitorimi të zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri ka qenë pjesa që ka të bëjë me rekomandimet për përmirësimin e procesit zgjedhor. Tradicionalisht, kjo është përkthyer në diskutime mbi aspekte të ndryshme të sistemeve zgjedhore dhe preferenca për një apo një tjetër sistem zgjedhor.

#### GJETJET E ANKETIMIT KOMBËTAR

Shqiptarët priren të mos jenë dakord me pohimin "Sistemi aktual zgjedhor për Kuvendin e Shqipërisë e pasqyron plotësisht vullnetin e qytetarëve" (N=1181). Në një shkallë nga 0 (aspak dakord) në 10 (plotësisht dakord), evidentohet një vlerë mesatare prej 3.56 dhe DS prej 3.18. Këto vlera sugjerojnë një nivel relativisht të ulët besimi të sistemi i tanishëm zgjedhor.

Megjithatë, niveli i dakordësisë për pohimin tjetër, "Ndarja administrativo-territoriale e vitit 2014 imponon zona elektorale të cilat e deformojnë vullnetin e zgjedhësve në votime për zgjedhjet lokale ose parlamentare" (N=1097), gjendet diku në mes. Pra, të dhënat nga anketimi kombëtar sugjerojnë një mesatare prej 5.16 dhe DS prej 3.24. Kjo do të thotë se shqiptarët janë neutralë për një supozim të tillë, as nuk e mbështesin por as nuk e kundërshtojnë atë.


FIGURA 15: 32. SIPAS NDARJES ADMINISTRATIVO-TERRITORIAL TË VITIT 2014 SHQIPËRIA PËRBËHET NGA... (%) (N=830)



Sistemi aktual zgjedhor – proporcional rajonal – është paksa i ndërlikuar. Listat rajonale hartohen sipas ndarjes territoriale të vendit, me gjithsej 12 qarqe. Në këtë anketim kombëtar u testuan njohuritë e të anketuarve për ndarjen territoriale të vendit, që, sipas ligjit të vitit 2014, u reduktua numri i njësive të qeverisjes vendore,<sup>17</sup> në 12 qarqe dhe 61 bashki. Siç jepet edhe në Figurën 15, vetëm një në pesë shqiptarë (20.2%) ka zgjedhur përgjigjen e duhur, “Asnjë nga sa më sipër”.

Shqiptarët kanë mangësi njohurish edhe për legjislacionin e miratuar për zgjedhjen e deputetëve të Kuvendit dhe për mënyrën se si përfshihen ata në listat e votimit. Sipas anketimit kombëtar, vetëm një nga katër të anketuar (25.2%) mund të identifikonin pohimin e saktë për sistemin zgjedhor në Shqipëri, “Votuesit mund të shprehin preferencën e tyre për një kandidat partie”.


**FIGURA 16: CILAT NGA TË MËPOSHTMET (NËSE KA) JANË TË VËRTETA PËR SISTEMIN QË PËRDORET AKTUALISHT PËR ZGJEDHJEN E DEPUTETËVE TË KUVENDIT?? (%) (N=1200)**



Niveli i ulët i besimit në sistemin zgjedhor i kombinuar me nivelin e ulët të njohurive për procedurat dhe rregullat e këtij sistemi shoqërohen me skepticizmin e madh të publikut ndaj politikanëve dhe deputetëve në përgjithësi. Kështu,

më shumë se gjysma e të anketuarve sipas anketimit kombëtar mendojnë se deputetët janë “pak” (27.7%) ose “aspak” (35.4%) të informuar për prioritetet dhe shqetësimet e qytetarëve në vend. (Shih Figurën 17).

**FIGURA 17: SA TË INFORMUAR MENDONI SE JANË DEPUTETËT PËR PRIORITETET DHE SHQETËSIMET E QYTETARËVE NË VEND? (%) (N=1178)**




17 Ligji Nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”

18 Në këtë pyetje lejohet më shumë se një përgjigje.

Megjithatë, të anketuarit e anketimit kombëtar ishin disi të ndarë kur vjen puna te gatishmëria për të ndërvepruar me politikanët dhe deputetët. Siç tregohet edhe në Figurën 18, pjesa më e madhe e të anketuarve do të kontaktonin me politikanë apo deputetë dhe vetëm 23.9% thanë se nuk janë aspak të gatshëm të kontaktojnë me deputetë

apo politikanë. Nga ana tjetër, të anketuarit që konfirmojnë se janë të gatshëm të ndërveprojnë janë të ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë me ata që janë “jashtëzakonisht të gatshëm” apo “shumë të gatshëm” dhe ata që janë “mesatarisht” apo “pak të gatshëm” për të kontaktuar me politikanë apo deputetë.

**FIGURA 18: SA TË GATSHËM DO TË ISHIT PËR TË KONTAKTUAR ME POLITIKANË OSE DEPUTETË QOFTË FIZIKISHT, QOFTË ME SHKRIM APO NË FORMA TË TJERA? (%) (N=1168)**



Në pjesën e mëposhtme analizohen qëndrimet e grupit eksperimental dhe të kontrollit në lidhje me katër ndryshimet e propozuara për sistemin zgjedhor në Shqipëri. Siç theksohet edhe nga raporti, këto qëndrime janë të krahasueshme

me njëra tjetrën dhe jo me të dhënat e anketimit kombëtar. Megjithatë, për të kuptuar më mirë kontekstin kombëtar, në Tabelën 5 paraqitet niveli i mbështetjes nga të anketuarit për alternativat e ndryshme për sistemin aktual zgjedhor.

**Tabela 5. Mbështetja për ndryshimin e sistemit zgjedhor (Anketimi kombëtar)**

MASA E PROPOZUAR	N		MESATARJA	DEVIJIMI STD.	MIN.	MAKS.
	VLERAT E VLEFSHME	VLERAT QË MUNGOJNË				
Kalimi nga sistemi aktual proporcional rajonal në sistemin proporcional kombëtar (me vetëm një listë kombëtare).	1041	159	5.96	2.915	0	10
Kalimi tek listat plotësisht të hapura në sistemin aktual zgjedhor.	1138	62	6.97	2.791	0	10
Kalimi në sistem të pastër mazhoritar ( <i>deputeti i çdo zone zgjidhet me shumicën e votave të qytetarëve</i> ).	1144	56	7.80	2.558	0	10

MASA E PROPOZUAR	N		MESATARJA	DEVIJIMI STD.	MIN.	MAKS.
	VLERAT E VLEFSHME	VLERAT QË MUNGOJNË				
Rikthimi në sistemin e mëparshëm zgjedhor me zgjedhjen e 100 deputetëve me sistem mazhoritar dhe 40 me sistem proporcional.	1074	126	5.06	3.242	0	10


Shënim: Shkalla, 0 – E kundërshtoj tërësisht; 10 – E mbështes plotësisht

Siç tregohet në Tabela 5, shqiptarët janë relativisht neutralë ndaj alternativës së parë (proporcional kombëtar) dhe të fundit (rikthimi në sistemin e mëparshëm të përzier). Në vend të tyre, ata prireshin të favorizonin ato alternativa që ofrojnë lidhje më të qëndrueshme mes zgjedhësve dhe deputetëve (jo partive). Kështu, këto alternativa janë sistemi i pastër mazhoritar dhe listat plotësisht të hapura sipas sistemit aktual zgjedhor proporcional rajonal.

#### GRUPI EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT

Nga analiza krahasuese e të dhënave nga anketimet me grupin eksperimental dhe të kontrollit konstatohet se pozicionet dhe qëndrimet e pjesëmarrësve në grupin eksperimental ishin të ndryshme vetëm për dy nga katër alternativat për ndryshimin e sistemit aktual zgjedhor në Shqipëri. Informacioni mbi avantazhet dhe disavantazhet e secilit prej propozimeve, i cili iu dha pjesëmarrësve përmes aktivitetit katër-ditor, duket se ka çuar në një rritje të ndjeshme të nivelit të mbështetjes për alternativat.

FIGURA 19: MESATARJA PËR PROPOZIMET PËR REFORMËN ZGJEDHORE - GRUPIN EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT



*“Kalimi nga sistemi aktual proporcional rajonal në sistemin proporcional kombëtar (me vetëm një listë kombëtare).”*

Në një shkallë nga 0 (e kundërshtoj tërësisht) në 10 (e mbështes plotësisht), grupi eksperimental kishte një vlerë mesatare prej 6.48 dhe DS prej 3.23, ndërkohë që grupi i kontrollit kishte një vlerë mesatare prej 6.09 dhe DS prej 2.76. Testi-t nuk nxori në pah dallime të mëdha mes këtyre dy grupeve. Kjo do të thotë se njohuritë dhe informacionet e reja si dhe mundësia për të shkëmbyer ide dhe pikëpamje me anëtarë të tjerë të grupit dhe me ekspertët nuk pati ndikim të madh në qëndrimet e pjesëmarrësve të grupit eksperimental.

*“Kalimi tek listat plotësisht të hapura në sistemin aktual zgjedhor.”*

Niveli i mbështetjes për alternativën e dytë u rrit ndjeshëm për pjesëmarrësit që morën njohuri dhe informacione nga aktiviteti i nëntorit 2021. Kështu, grupi eksperimental kishte një mesatare prej 8.84 dhe DS prej 1.81 për këtë pohim, ndërsa grupi i kontrollit kishte një mesatare prej 6.47 dhe DS prej 2.55. Ka dallime mes këtyre grupeve, pasi të dhënat e grupit eksperimental kanë vlerë mesatare më të lartë se grupi i kontrollit. Kjo sugjeron që njohuritë e reja të marra në aktivitetin katër-ditor ndikuan që pjesëmarrësit të tregonin një nivel më të lartë mbështetjeje sesa pjesëmarrësit nga grupi që nuk ishin të informuar për avantazhet dhe dobësitë.

*“Kalimi në sistem të pastër mazhoritar (deputeti i çdo zone zgjidhet me shumicën e votave të qytetarëve).”*

Një tjetër pohim që mori mbështetje më të madhe nga pjesëmarrësit e grupit eksperimental ishte propozimi për zbatimin e sistemit zgjedhor mazhoritar. Ashtu si alternativa e mëparshme ku propozohet kalimi në lista plotësisht të hapura (duke lejuar kështu që vota preferenciale e votuesve vendos se kush zgjidhet dhe jo renditja e kandidatëve), kjo alternativë nxit, nga ana tjetër, lidhje më të drejtpërdrejta mes zgjedhësve dhe kandidatëve potencialë. Grupi eksperimental kishte një vlerë mesatare 7.78 dhe DS prej 3.17 për këtë pohim, ndërsa grupi i kontrollit kishte një vlerë mesatare prej 5.82 dhe DS prej 3.34. Testi-t nxori në pah dallime mes dy grupeve me një vlerë më të lartë për grupin eksperimental. Kjo do të thotë se pjesëmarrësit që kishin marrë informacione treguan mbështetje më të madhe për këtë lloj sistemi

zgjedhor në krahasim me pjesëmarrësit e grupit të kontrollit që nuk kishin njohuri për këtë sistem.

*“Rikthimi në sistemin e mëparshëm zgjedhor me zgjedhjen e 100 deputetëve me sistem mazhoritar dhe 40 me sistem proporcional.”*

Së fundi, pjesëmarrësit e grupit eksperimental dhe grupit të kontrollit nuk shfaqën dallime të konsiderueshme për sa i përket mendimit për mundësinë e rikthimit në sistemin e mëparshëm zgjedhor të Shqipërisë. Grupi eksperimental kishte një mesatare prej 5.72 dhe DS prej 3.63, ndërsa grupi i kontrollit kishte një mesatare prej 4.92 dhe DS prej 2.91. Prandaj, nuk pati dallime të mëdha mes dy grupeve. Kjo do të thotë se pavarësisht nëse kanë marrë njohuri të reja apo jo, pjesëmarrësit treguan qëndrime të ngjashme ndaj këtij propozimi. Në një shkallë nga 0 (e kundërshtoj tërësisht) në 10 (e mbështesin tërësisht), ata prireshin të ishin neutralë.





Shqipëria është vendi me një nga diasporat më të mëdha në botë. Më shumë se një e treta e shtetasve të saj jetojnë në mënyrë të përhershme jashtë vendit. Sipas të dhënave të INSTAT, mbi 36% e rreth 4.4 milionë shtetasve shqiptarë jetojnë jashtë Shqipërisë: brenda jetojnë rreth 2.78 milionë shtetas, ndërsa jashtë jetojnë rreth 1.64 milionë shtetas.

Shqiptarët që jetojnë jashtë vendit kanë të drejtë të votojnë. Kodi Zgjedhor përcakton se për të ushtruar të drejtën e votës, shtetasit duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile; dhe të kenë vendbanimin e regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit. Si rezultat, shumë prej shqiptarëve që jetojnë jashtë janë të regjistruar në një qendër votimi, zakonisht në atë ku ka qenë banesa e fundit e tyre para emigrimit. Kjo është arsyeja pse në listat e votimit janë rreth 3.6 milionë votues edhe pse në Shqipëri jetojnë më pak se 2.8 milionë banorë.

Gjithsesi, pavarësisht se kanë të drejtën e votës dhe ndonëse mund të jenë të regjistruar në Regjistrin


e Zgjedhësve, e vetmja mënyrë për ta ushtruar të drejtën e votës për ta është të vinë fizikisht në Shqipëri për të votuar.

Votimi i diasporës është një çështje e ndjeshme, pasi ka qenë burim i shumë parregullsive në zgjedhje gjatë tre dekadave të fundit. Nevojitet konsensus i gjerë politik për mënyrën e regjistrimit të zgjedhësve që jetojnë jashtë vendit, si do të votojnë ata dhe si do të numërohen votat e tyre. Nevojitet konsensus edhe për vendin se ku do të numërohen votat e diasporës.

### GJETJET E ANKETIMIT KOMBËTAR

Pjesa më e madhe e shqiptarëve të anketuar duket se nuk janë të informuar nëse diaspora shqiptare ka të drejtën ligjore për të votuar në zgjedhjet vendore apo parlamentare. Vetëm rreth një e treta e të anketuarve (33%) identifikuan saktë se, sipas Kodit Zgjedhor, shqiptarët me banim jashtë vendit kanë të drejtë të votojnë në zgjedhjet vendore ose parlamentare në Shqipëri. (Shih Figurën 20).

FIGURA 20: SIPAS KODIT ZGJEDHOR, A MUND TË VOTOJË DIASPORA SHQIPTARE (QYTETARË SHQIPTARË ME BANIM TË PËRHERSHËM JASHTË VENDIT) NË ZGJEDHJET VENDORE DHE PARLAMENTARE NË SHQIPËRI? (%)



Të dhënat e anketimit kombëtar sugjerojnë më tej se në shoqërinë shqiptare ekziston mbështetja që nevojitet për të bërë të mundur në praktikë votimin nga diaspora. Përgjigjet për pyetjen "sa e mbështesni apo kundërshtoni faktin që qytetarët shqiptarë që jetojnë jashtë vendit të mund të votojnë në zgjedhjet në Shqipëri?" (N=1179), regjistruar në

një shkallë nga 0 (e kundërshtoj tërësisht), në 10 (e mbështes plotësisht), kishte një vlerë mesatare prej 7.98 dhe DS prej 2.87. Kjo do të thotë se shumica e shqiptarëve priren të mbështesin të drejtat e bashkëkombësve të tyre që jetojnë jashtë për të thënë fjalën e tyre në zgjedhjet politike në Shqipëri.

Gjithsesi, kur u pyetën për mënyrat e ndryshme që mund të funksionojë në praktikë votimi i diasporës, një konsensus i tillë i gjerë është pak më i vogël, ndonëse në kahun e “mbështetjes” në bosht. Siç

vërehet në Tabelën 6, votimi me postë dhe votimi në misionet diplomatike janë përgjithësisht më pak të favorizuara në krahasim me dy alternativat e tjera.

**Tabela 6. Mbështetja për votimin e diasporës (anketimi kombëtar)**

MASA E PROPOZUAR	N		MESATARJA	DEVIJIMI STD.	MIN.	MAKS.
	VLERAT E VLEFSHME	VLERAT QË MUNGOJNË				
Qytetarëve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit duhet t’u mundësohet votimi për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri pranë misioneve tona diplomatike në shtetet e huaja.	1188	12	6.72	3.374	0	10
Qytetarëve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit duhet t’u mundësohet votimi për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri me postë të zakonshme.	1187	13	5.34	3.609	0	10
Qytetarëve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit duhet t’u mundësohet votimi elektronik për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri.	1187	13	6.92	3.311	0	10
Shqipëria duhet të sigurojë vende të dedikuara në parlament për të cilat diaspora shqiptare (qytetarët shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit) të votojë dhe të zgjidhet.	1179	21	7.19	3.144	0	10


*Shënim: Shkalla 0 – e kundërshtoj tërësisht; 10 – e mbështes plotësisht*

### GRUPI EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT

Pjesëmarrësit e eksperimentit social, si nga grupi eksperimental ashtu edhe ai i kontrollit, treguan tendenca të ngjashme me të anketuarit e anketimit kombëtar në lidhje me mbështetjen për alternativat e ndryshme që mund ta bënin realitet votimin e diasporës. Gjithsesi, kjo pjesë ka si qëllim të krahasojë qëndrimet e pjesëmarrësve në varësi të faktit nëse kanë marrë informacione shtesë për avantazhet dhe disavantazhet e secilës alternativë.

Në këtë kontekst, është me interes të theksohet se për tre nga katër format, testi-t nuk evidenton dallime të mëdha mes dy grupeve.

FIGURA 21: MESATARJA PËR ZBATIMIN E FORMAVE PËR VOTIMIN E DIASPORËS - GRUPI EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT



### *“Votimi pranë misioneve diplomatike të Shqipërisë jashtë vendit”*

Grupi eksperimental kishte një vlerë mesatare prej 6.14 dhe DS prej 3.68, ndërkohë që grupi i kontrollit kishte një vlerë mesatare prej 6.67 dhe DS prej 2.80. Nuk pati dallime të mëdha mes dy grupeve. Kjo do të thotë se niveli i mbështetjes për këtë alternativë mbetet i pandikuar nga fakti nëse pjesëmarrësit kishin marrë informacione objektive dhe njohuri për të apo jo.

### *“Votimi me postë të zakonshme”*

Nuk u vërejtën dallime për këtë alternativë mes dy grupeve. Grupi eksperimental kishte një mesatare prej 5.32 dhe DS prej 3.68; kurse grupi i kontrollit kishte një mesatare prej 5.77 dhe DS prej 3.12. Kjo do të thotë se njohuritë dhe informacionet e reja, si dhe mundësia për të shkëmbyer mendime me pjesëtarët e tjerë të grupit dhe ekspertët nuk ndikuan shumë në qëndrimet e pjesëmarrësve.

### *“Votimi elektronik”*

Ashtu si me dy alternativat e mësipërme, nuk pati

dallime të mëdha mes pjesëmarrësve të grupit eksperimental dhe atyre të grupit të kontrollit. Grupi eksperimental kishte një vlerë mesatare prej 7.68 dhe DS prej 3.41, ndërkohë që grupi i kontrollit kishte një vlerë mesatare prej 7.32 dhe DS prej 2.61. Kjo do të thotë se pavarësisht faktit nëse kishin marrë apo jo njohuri, pjesëmarrësit e anketuar shfaqën qëndrime të ngjashme për këtë alternativë.

### *“Vende të dedikuara në parlament për të cilat diaspora shqiptare mund të votojë dhe të zgjidhet.”*

Forma e fundit që do të bënte të mundur votimin e diasporës nxori në pah dallime të mëdha mes dy grupeve. Grupi eksperimental kishte një vlerë mesatare prej 7.60 dhe DS prej 3.27, ndërsa grupi i kontrollit kishte një vlerë mesatare prej 6.75 dhe DS prej 2.78. Grupi eksperimental kishte vlerë mesatare më të lartë se grupi i kontrollit. Kjo sugjeron që pjesëmarrësit që morën informacione dhe njohuri në aktivitetin katërditor prireshin ta mbështesnin më shumë këtë alternativë në krahasim me të anketuarit e grupit të kontrollit që nuk kishin marrë pjesë në aktivitetin në fjalë

Mjedisi ka qenë një pjesë e vazhdueshme e debatit politik në dy dekadat e fundit, veçanërisht për sa i përket shërbimeve mjedisore, të tilla si çështjet që lidhen me menaxhimin e integruar të mbetjeve, trajtimin e ujërave të zeza, etj. Në vitet e fundit, gjithsesi, debati ka mbuluar edhe çështje të tjera, si ndryshimet klimatike, sektorin e transportit të qëndrueshëm, efektet në mjedis nga termocentralet dhe hidrocentralet, prerjet e paligjshme, gjuetia, mirëqenia e kafshëve etj.

Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Parisit më 14 korrik 2016, duke hyrë në fazën e re të politikave ndërkombëtare të klimës. Në këto politika është përfshirë edhe sektori i transportit, që është konsumatori më i madh i energjisë me 40% në vitin 2018.<sup>19</sup> Gjatë këtyre viteve, rritja e ndjeshme e numrit të automjeteve në rrugë në Shqipëri u shoqërua me rritje të aktivitetit të transportit dhe rritje të dukshme të konsumit të karburanteve, kryesisht naftë dhe benzinë.


Për të luftuar efektet e ndryshimeve klimatike dhe për të parandaluar ndotjen e mëtejshme të mjedisit,

mund të ndërmerren disa masa. Gjithsesi, për masa të tilla dalin përpara sfida të ndryshme, përfshirë këtu, por pa u kufizuar vetëm në to, kostot e larta për buxhetin e shtetit dhe rrjedhimisht për qytetarët, infrastrukturën e vjetër të transportit, kapacitetin e bizneseve për të përmbushur standardet mjedisore, etj. Një tjetër sfidë e madhe është ndërgjegjësimi i publikut dhe gatishmëria e qytetarëve për të bashkëpunuar për një mjedis më të shëndetshëm, dekarbonizimi dhe parandalimi i efekteve të tjera të ndryshimeve klimatike.

**GJETJET E ANKETIMIT KOMBËTAR**

Ndryshimet klimatike janë një temë relativisht e re në debatin publik në Shqipëri. Për më shumë se një dekadë, vëmendjen e publikut e kanë marrë kauza të ndryshme mjedisore, të cilat kanë qenë në qendër të fushatave dhe protestave të qytetarëve, si p.sh., importi i mbetjeve, çmontimi i armëve kimike, mbrojtja e lumenjve, etj.

**FIGURA 22: A KA SHQIPËRIA NDONJË LIGJ PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE? (%)**



19 IRENA (Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë së Rinovueshme - International Renewable Energy Agency), Vlerësim për gatishmërinë e energjisë së rinovueshme – Republika e Shqipërisë, mars 2021, p 21, [https://www.irena.org/-/media/Files/IRENA/Agency/Publication/2021/March/IRENA\\_RRA\\_Albania\\_2021.pdf](https://www.irena.org/-/media/Files/IRENA/Agency/Publication/2021/March/IRENA_RRA_Albania_2021.pdf).


Në dhjetor 2020, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një ligj për ndryshimet klimatike, që hyri në fuqi në korrik 2021.<sup>20</sup> Ky ligj përbën reagimin në nivel kombëtar ndaj ndryshimeve globale klimatike dhe detyrimet që kanë ndërmarrë shumë shtete sipas konventës kuadër të OKB-së për ndryshimet klimatike (1992).

Ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me ndryshimet klimatike nuk duket se është në përpjesëtim me shkaqet e hershme mjedisore. Pothuajse 60% e shqiptarëve thonë se nuk e dinë nëse Shqipëria ka miratuar një ligj për ndryshimet klimatike. Në fakt, vetëm një në pesë shqiptarë ka dëgjuar për një ligj të

tillë. (Shih Figurën 22).

Është me interes të theksohet se ndonëse të anketuarit e konsiderojnë serioze ndotjen në zonat e tyre dhe po ashtu edhe kërcënimin nga ngrohja globale, një përqindje më e lartë e shqiptarëve janë të shqetësuar për ngrohjen globale. Siç tregohet në Figurën 23, më shumë se gjysma e shqiptarëve (56.6%, N=1163) e konsiderojnë kërcënimin e ngrohjes globale si shumë serioz, krahasuar me 41.8% (N=1195) që raportojnë ndotjen në zonën e tyre si shumë serioze.

FIGURA 23: NDOTJA NË ZONËN VENDORE KRAHASUAR ME NGROHJEN GLOBALE



Megjithatë, pavarësisht se të anketuarit raportojnë një nivel shumë të lartë shqetësimi për ndotjen dhe ngrohjen globale, një qëndrim i tillë nuk përputhet me të njëjtin apo edhe një nivel të ngjashëm gatishmërie për të vepruar. Kështu, të pyetur nëse janë “të gatshëm të paguajnë taksa më të larta në mënyrë që të mbrojnë mjedisin” (N=1182), mesatarja e përgjigjeve të të anketuarve ishte 4.13 dhe me një DS prej 3.51 në shkallën 0 (e kundërshtoj tërësisht) në 10 (e mbështes plotësisht). Testi-t për këtë pohim nuk tregoi dallime të mëdha mes dy grupeve eksperimentale dhe të kontrollit, që do të thotë se të anketuarve u mungonte vullneti edhe pasi atyre iu dha informacion objektiv për këtë çështje.

Një hendek i tillë mes nivelit të shqetësimi për

ndotjen në zonat e tyre dhe për ngrohjen globale (siç perceptohen nga të anketuarit) dhe gatishmërisë për të vepruar ndaj shqetësimeve të tilla tregon se ka ende shumë punë për të bërë për rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe informimit për problemet mjedisore tek qytetarët e thjeshtë. Në fakt, një nevojë e tillë përforcohet edhe nga gjetjet që jepen më poshtë.

#### GRUPI EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT


Pavarësisht detyrimeve zyrtare që ka marrë përsipër Shqipëria në kuadër të ndryshimeve klimatike, tema mbetet relativisht e re dhe qytetarët kanë

20 Ligji Nr. 155/2020, 17 dhjetor 2020.

nevojë për më shumë kohë dhe informacion për të kuptuar më mirë sfidat e ndryshimeve klimatike. Ashtu si me anketimin kombëtar, të anketuarit e të dy grupeve shfaqën një hendek mes deklarimit të mbështetjes dhe gatishmërisë së tyre faktike për të vepruar. Në një shkallë nga 0 (e kundërshtoj tërësisht) në 10 (e mbështes plotësisht), pjesëmarrësit prireshin të qëndronin rreth vlerave

neutrale të boshtit (mesatarja = 5 deri në 6) për pjesën më të madhe të masave të propozuara. Për më tepër, testi-t nuk evidentoi dallime të mëdha mes grupit eksperimental dhe atij të kontrollit për asnjë nga masat e propozuara për uljen e ndikimit të ndryshimeve klimatike dhe për parandalimin e degradimit të tij mjedisor.

**FIGURA 24: MESATARJA PËR PROPOZIMET PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE - GRUPI EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT**



***“Të bëhet i detyrueshëm emetimi zero i karbonit për makinat, kamionët, autobusët deri në 2035.”***

Grupi eksperimental kishte një vlerë mesatare prej 6.40 dhe DS prej 3.28, ndërkohë që grupi i kontrollit kishte një vlerë mesatare prej 7.16 dhe DS prej 2.49. Nuk pati dallime të mëdha mes dy grupeve. Kjo do të thotë se pavarësisht nga informacioni i dhënë dhe mundësia për të bashkëvepruar me anëtarë të tjerë të grupit dhe me ekspertë, pjesëmarrësit e këtij eksperimenti social nuk ndryshuan aq shumë qëndrimet dhe nivelin e mbështetjes për këtë masë të veçantë.

***“Të ndalohet importi i makinave të përdorura më shumë se 5 vjet”***

Pjesëmarrësit e grupit eksperimental dhe ai i kontrollit duken edhe më neutralë ndaj masës tjetër të propozuar, e cila synon kufizimin e importit të

automjeteve të përdorura duke lejuar vetëm ato deri në pesë vjet. Grupi eksperimental kishte një vlerë mesatare prej 5.13 dhe DS prej 3.52, ndërsa grupi i kontrollit kishte një vlerë mesatare prej 5.16 dhe DS prej 2.98. Në testin-t nuk u vunë re dallime të mëdha mes dy grupeve, që do të thotë se përgjigjet e pjesëmarrësve janë rreth vlerave neutrale, pavarësisht nga niveli i informacionit të marrë prej tyre.

***“Në qytetet e mëdha të krijohen zona me emetim të ulët”***

Grupi eksperimental kishte një vlerë mesatare prej 6.67 dhe DS prej 3.64, ndërsa grupi i kontrollit kishte një vlerë mesatare prej 6.54 dhe DS prej 2.66. Nuk u evidentuan dallime të mëdha mes dy grupeve, që do të thotë se pjesëmarrësit që morën informacione shtesë për avantazhet dhe disavantazhet e këtij propozimi nuk dukeshin se ishin shumë të ndikuar prej këtij informacioni.

Gjatë tre dekadave të fundit, rreth 1.64 milionë shtetas shqiptarë jetojnë sot në mënyrë të përhershme në vende të tjera,<sup>21</sup> teksa Shqipëria përjetoj disa valë emigrimi. Ritmet e larta të emigrimit kanë vazhduar<sup>22</sup> dhe pritet që emigrimi i shqiptarëve të vazhdojë me ritme të larta në vitet e ardhshme, kryesisht përmes rrugëve të ligjshme (p.sh., bashkimi familjar dhe emigrimi në kuadër të programeve të emigrimit të vendeve perëndimore).

Megjithatë, pas krizave ekonomike në vendet që janë destinacionet më të njohura të emigrimit (si Greqia) dhe krizave të refugjatëve në Evropë në vitin 2015 dhe pasojave të tyre, në Shqipëri janë vënë re forma të reja migrimi, përfshirë migracionin e intensifikuar të kthimit,<sup>23</sup> dhe një rritje të Shqipërisë që vepron si vend tranzit dhe/ose destinacioni përfundimtar.<sup>24</sup> Këto tendenca të reja u shfaqën te të dhënat zyrtare në vitin 2018, kur Shqipëria filloi të përfshijë azilkërkuesit dhe rezidentët e huaj në statistikat e saj zyrtare. Në atë vit u raportuan gjithsej 4386 azilkërkues dhe 9090 rezidentë të huaj.<sup>25</sup> Këto zhvillime dhe vëmendja në rritje në debatin politik dhe mediatic për rolin e Shqipërisë si vend origjine dhe si vend i mundshëm pritës për migrantët kanë ngritur shqetësime dhe/ose ndjenja që më parë ishin të parëndësishme për një vend ku mbizotëron emigrimi neto.<sup>26</sup>

Kuvendi i Shqipërisë miratoi një ligj të ri për të huajt në vitin 2021.<sup>27</sup> Qëllimi i këtij ligji është të përafrojë praktikën shqiptare të hyrjes dhe qëndrimit në vend të shtetasve të huaj me standardet evropiane. Krahas përmirësimit të sistemit të vizave në

përgjithësi, ligji rregullon futjen dhe qëndrimin në Shqipëri për qëllime punësimi të shtetasve të huaj të të gjitha llojeve dhe fushave, përfshi imigrantët e përkohshëm ekonomikë.

Ligji lehtëson ndjeshëm mënyrën e marrjes së lejes së punës dhe lejes së qëndrimit për shtetasit e huaj që kanë një ofertë pune në Shqipëri, për të gjitha llojet e punësimit. Duke qenë se ekonomia e Shqipërisë ofron pak mundësi për punë të kualifikuara, përfituesit kryesorë nga ky ligj mund të jenë punëtorët e pakualifikuar. Ky parashikim përforcohet nga nevoja e shprehur publikisht nga kompani fashone dhe të ndërtimit për të marrë punonjës të kualifikuar, pasi nuk gjejnë shqiptarë që mund të bëjnë punët që ofrojnë këto kompani. Në fakt, një sërë kompanish shqiptare kanë punësuar, tashmë, punëtorë nga Bangladeshi dhe disa vende të tjera të pazhvilluara.<sup>28</sup> Gjithsesi, imigrimi ekonomik në Shqipëri është një dukuri relativisht e re në debatin publik dhe është parë me pesimizëm nga një pjesë e opinionit publik, analistëve publikë dhe politikanëve.

## GJETJET E ANKETIMIT KOMBËTAR

Të anketuarit e anketimit kombëtar treguan nivele të ulëta të mirëkuptimit për ligjin për të huajt dhe shkallën e papunësisë në Shqipëri. Pothuajse gjysma e të anketuarve (47.2%) raportuan se “nuk e dinë” se për çfarë bëhet fjalë në Ligjin “Për të huajt”. (Shih Figurën 25).

21 ‘Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021–2025’ miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 585, 22 korrik 2020 <https://diaspora.gov.al/wp-content/uploads/2020/08/STRATEGJIA-KOMBETARE-E-DIASPORES-2021-2025-2.pdf>

22 Komisioni Evropian, ‘Gjetjet kryesore nga raporti 2021 për Shqipërinë, 2021, <https://ec.europa.eu/>

23 E Dhëmbo, V Duci dhe Z Vathi, ‘Migrimi i kthimit dhe të drejtat e njeriut në Shqipëri, rasti i mbrojtjes sociale, Buletini i të Drejtave të Njeriut dhe Punës Sociale, 4, 55–62, <https://doi.org/10.1007/s41134-018-0078-z>

24 E Dhëmbo, E Çaro, and J Hoxha, ‘“Migranti ynë” dhe “migranti tjetër”’: debati për migrimin në mediat shqiptare, 2015–2018’, *Humanit Soc Sci Commun*, 8, 317, <https://doi.org/10.1057/s41599-021-00981-w>


25 INSTAT, Të huajt dhe azilkërkuesit në Shqipëri, 2019, <http://www.instat.gov.al/>

26 E. Dhëmbo, E. Çaro, dhe J. Hoxha, ‘“migranti ynë” dhe “migranti tjetër”’.

27 Ligji Nr. 79/2021 “Për të huajt”, marrë nga: <https://www.parlament.al/Files/Akte/2021070817284820210705135531ligj%20nr.%2079%20dt.%2024.6.2021.pdf>


28 Elvis Hila, ‘Migrantët aziatikë zënë punët që refuzohen nga shqiptarët nazelinj’, *Balkan Insight*, 20 korrik 2021, <https://balkaninsight.com/2021/07/20/asian-migrants-fill-jobs-that-picky-albanians-now-spurn/>.

**FIGURA 25: SIPAS MENDIMIT TUAJ, LIGJI I RI PËR TË HUAJT (2021) NË SHQIPËRI LEHTËSON? (%) (N=656)**



Gjithashtu, një në katër shqiptarë (27.8%) besojnë se niveli i papunësisë në Shqipëri është “më shumë se 30%”, dhe 31,5% e të anketuarve janë përgjigjur “nuk e di”. (Shih Figurën 26).

**FIGURA 26: NË VITIN 2020, SA ISHTE NIVELI I PAPUNËSISË NË SHQIPËRI? (%) (N=836)**



Qëndrimet e publikut ndaj imigrimit u shqyrtuan përmes një sërë pohimesh me anë të të cilave u kërkohej të anketuarve të anketimit kombëtar të shprehnin dakordësinë ose kundërshtimin e tyre. Në përgjithësi, nga njëra anë, shqiptarët janë relativisht neutralë ndaj pohimeve që synojnë të testojnë

pranimin prej tyre të imigrantëve të huaj ekonomikë. Nga ana tjetër, ata tregojnë mbështetje të madhe që të jepen paga më të larta për shqiptarët në vend që të importohen imigrantë të huaj. (Shih Tabelën 7).



Tabela 7: Qëndrimet ndaj problemeve të imigrimit ekonomik (anketimi kombëtar)

POHIMET	N		MESATARJA	DEVIJIMI STD.	MIN.	MAKS.
	VLERAT E VLEFSHME	VLERAT QË MUNGOJNË				
Shqipëria duhet të nxisë bizneset që të paguajnë paga më të larta për qytetarët shqiptarë dhe jo të importojnë imigrantë të huaj.	1194	6	8.31	2.560	0	10
Imigrantët përmirësojnë shoqërinë tonë duke sjellë ide e kultura të reja.	1190	10	4.57	3.307	0	10
Imigrantëve të rregullt në Shqipëri duhet t'u njihet e drejta për të votuar në zgjedhjet vendore.	1173	27	5.02	3.555	0	10

Shënim: Shkalla 0 – e kundërshtoj tërësisht; 10 – e mbështes plotësisht

Më shumë se gjysma e të anketuarve ishin në favor të pohimit "Shqipëria duhet të nxisë bizneset që të paguajnë paga më të larta për qytetarët shqiptarë dhe jo të importojnë imigrantë të huaj.". Vlera mesatare për këtë pohim shkoi deri në 8.31 dhe me një DS prej 2.57 në një shkallë nga 0 (e kundërshtoj tërësisht) në 10 (e mbështes plotësisht).

Për pohimet, "Imigrantët përmirësojnë shoqërinë tonë duke sjellë ide e kultura të reja" dhe "Imigrantëve të rregullt në Shqipëri duhet t'u njihet e drejta për të votuar në zgjedhjet vendore", të anketuarit prireshin të anonin drejt mesit. Konkretisht, pohimi i parë kishte një vlerë mesatare prej 4.57 dhe DS prej 3.30, ndërkohë që për pohimin tjetër, të dhënat e anketimit kombëtar evidentuan një vlerë mesatare prej 5.02 dhe DS prej 3.56.

Në përgjithësi, qëndrimet e të anketuarve nga anketimi kombëtar për imigrimin ekonomik në Shqipëri sugjerojnë një këndvështrim më pak mbështetës, ndonëse jo tërësisht kundërshtues, ndaj imigrimit.

#### GRUPI EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT

Aktiviteti katër-ditor u fokusua tek avantazhet dhe disavantazhet e tendencës së fundit, sado modeste, të migrantëve që vijnë nga vendet e treta dhe shqetësimet e mundshme siç perceptohen nga shqiptarët. Për këtë temë të veçantë në anketim kishte vetëm një propozim, i cili ishte hartuar për t'u testuar për krahasim mes pjesëmarrësve të grupit eksperimental dhe atij të kontrollit.

FIGURA 27: MESATARJA PËR IMIGRANTËT EKONOMIKË - GRUPI EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT.



Grupi i kontrollit



Grupi eksperimental

Shqipëria duhet të jetë e hapur të pranojë fuqi të huaj punëtore (-0.44)



*“Shqipëria duhet të jetë e hapur të pranojë fuqi të huaj punëtore (imigrantë)”*


Grupi eksperimental kishte një vlerë mesatare prej 5.5 dhe DS prej 3.22 dhe grupi i kontrollit kishte një vlerë mesatare prej 5.94 dhe DS prej 2.76. Rezultatet e testit-t nuk tregojnë dallime mes grupeve. Kjo do të thotë se pavarësisht se morën materiale informuese për këtë temë dhe patën mundësinë të shkëmbejnë ide e mendime me pjesëmarrës të tjerë dhe me ekspertë, pjesëmarrësit e këtij eksperimenti social nuk e ndryshuan nivelin e mbështetjes për këtë pohim. Kështu, qëndrimet e tyre mbetën rreth vlerave neutrale të boshtit të vlerësimit nga 0 (e kundërshtoj tërësisht) në 10 (e mbështes plotësisht). Ky konstatim është shumë i rëndësishëm, pasi tregon se shqiptarët nuk kanë domosdoshmërisht ndjenja të forta ndaj emigrantëve të huaj.

## 08 | MËSIMET NGA USHTRIMI I PARË I ANKETIMIT DELIBERATIV NË SHQIPËRI

Në përgjithësi, ushtrimi i demokracisë deliberative në Shqipëri vërtetoi se informacioni objektiv dhe mundësia për të diskutuar për tematika mund të kenë efekt të rëndësishëm në qëndrimet e njerëzve dhe cilësinë e debatit publik edhe për çështje që janë mjaft të debatuar dhe përçarëse. Nga totali prej njëzetë masash të propozuara për përmirësimin e situatës politike apo për të trajtuar shqetësime për çështje me rëndësi që kanë të bëjnë me tematika të synuara, për më shumë se gjysmën e tyre (11)

ka pasur dallime të mëdha mes përgjigjeve të pjesëmarrësve nga grupi eksperimental dhe grupi i kontrollit (këtu përfshihen 11 pohimet që jepen në fund të Figurës 28). Kjo do të thotë se pjesëmarrësit e grupit eksperimental që morën njohuri të reja dhe ndërvepruan me anëtarë të tjerë të grupit dhe me ekspertë të pavarur prireshin të kishin qëndrime dhe pozicione të ndryshme nga ata që nuk morën njohuri të tilla. (Shih Figurën 28).

FIGURA 28: GRUPI EKSPERIMENTAL KRAHASUAR ME GRUPIN E KONTROLLIT - PIKËT MESATARE TË DALLIMEVE DHE QËNDRIMEVE TË PËRBASHKËTA NDAJ PROPOZIMEVE PËR NDRYSHIM






Grupi i kontrollit



Grupi eksperimental



Shënim: të anketuarve të këtij anketimi iu kërkua të jepnin vlerësimin e tyre për çdo masë të propozuar (pohim) në një shkallë nga 0 – e kundërshtoj tërësisht, në 10 – e mbështes plotësisht.

Është me interes të theksohet se temat dhe propozimet për të cilat pjesëmarrësit e grupit eksperimental ndryshuan qëndrim në krahasim me grupin e kontrollit lidhen me tematika të tilla si demokracia e partive politike, mekanizmat e demokracisë së drejtpërdrejtë dhe mbikëqyrja. Për më tepër, informacioni i ri ndikoi që pjesëmarrësit të ishin më shumë në favor të një propozimi të

caktuar sesa pjesëmarrësit e grupit të kontrollit për pjesën më të madhe të masave politike (pohimeve) që u pyetën në anketim. Gjithsesi, për disa prej tyre ndryshimi ishte në kah të kundërt dhe ndikoi që pjesëmarrësit e grupit eksperimental të ishin më pak mbështetës sesa të anketuarit e grupit të kontrollit.

Nga ana tjetër, nuk u vunë re ndryshime në


qëndrimet e pjesëmarrësve të grupit eksperimental për pjesën më të madhe të propozimeve që lidhen me ndryshimet klimatike, sistemin zgjedhor, votimin e diasporës dhe imigrimin ekonomik (shih dhjetë pohimet në fillim të Figurës 28). Kjo mund të jetë pjesërisht për shkak të faktit se disa nga këto tema janë relativisht të reja në debatin publik në Shqipëri (p.sh., ndryshimet klimatike dhe imigrimi ekonomik). Kështu, ato janë tregues i ndërgjegjësimit të pamjaftueshëm të publikut, gjë që manifestohet edhe në vlerën mesatare për shumicën e këtyre pohimeve që sillen rreth vlerave neutrale (5 deri në 6, në një shkallë nga 0 në 10). Gjithsesi, kjo nuk vlen për pjesën më të madhe të pohimeve që patën një ndryshim në qëndrimin e pjesëmarrësve nga grupi eksperimental, pikët mesatare të të cilëve varionin në vlerat 8 dhe 9.

Nuk u evidentua ndonjë ndryshim në lidhje me një numër të konsiderueshëm propozimesh që lidhen

me proceset zgjedhore (vota e diasporës dhe sistemi zgjedhor). Këto janë tema që kanë një debat të vazhdueshëm dhe të ashpër politik dhe publik në Shqipëri.

Është interesante se ndryshimet dhe zhvendosjet e mësipërme në pozicionet dhe qëndrimet e pjesëmarrësve të eksperimentit social të IDM-së (siç dëshmohet nga grupi eksperimental dhe ai i kontrollit) ndodhën në kontekstin e një popullate e cila, sipas anketimit kombëtar, ishte mjaft e ngurtë kur bëhet fjalë për qëndrime, veçanërisht për çështjet politike. Siç tregohet në Figurën 29, ndonëse pjesa më e madhe e të anketuarve të anketimit kombëtar deklaruan se janë të hapur për të lexuar materiale ose për të dëgjuar njerëz që kanë opinione të kundërta dhe ofrojnë një këndvështrim të ndryshëm ndaj çështjeve politike, më pak se gjysma e popullatës konfirmoi se do të ishte e hapur për të ndryshuar aspekte të bindjeve personale politike.

**FIGURA 29: GATISHMËRIA PËR TË LEXUAR APO PËR TË DËGJUAR KËNDVËSHTRIME TË NDRYSHME TË ÇËSHTJEVE POLITIKE? (ANKETIM KOMBËTAR, N=1182) KRAHASUAR ME GATISHMËRINË PËR TË NDRYSHUAR APO RISHIKUAR ASPEKTE TË BINDJEVE PERSONALE POLITIKE? (ANKETIM KOMBËTAR, N=1154) (%)**



Më shumë se 62% e të anketuarve ishin (jashtëzakonisht/shumë/mesatarisht) të gatshëm për të dëgjuar perspektiva të reja, por vetëm 49% e popullatës ishte jashtëzakonisht, shumë, apo mesatarisht e gatshme për të ndryshuar apo rishikuar bindjet personale politike.

Nuk vihen re dallime të mëdha mes të anketuarve sipas kategorive të gjinisë, moshës, statusit apo sektorit të punësimit në lidhje me *"gatishmërinë për të lexuar apo dëgjuar perspektiva të ndryshme për çështjet politike"*. Përqindja e pjesëmarrësve në anketimin kombëtar që thanë se nuk janë "aspak të gatshëm" është në rënie të vazhdueshme me rritjen e nivelit arsimor të përfunduar dhe të ardhurave mujore.

Përsa i përket *"gatishmërisë për të ndryshuar apo rishikuar aspekte të bindjeve personale politike"*, nuk konstatohen dallime të mëdha në lidhje me gjininë, statusin apo sektorin e punësimit. Megjithatë, analiza e kategorive të tjera demografike të anketimit kombëtar nxjerr në pah gjetje interesante. Një përqindje më e lartë e të anketuarve të moshës +55 vjeç deklaruan se nuk janë aspak të hapur për të ndryshuar/rishikuar aspekte të bindjeve personale. Në përgjithësi, sa më i arsimuar të jetë i anketuari, aq më pak gjasa ka që ai të zgjidhë ose "jashtëzakonisht i hapur" ose "aspak të hapur". Së fundi, sa më të ulëta të jenë të ardhurat mujore, aq më e lartë është përqindja e të anketuarve që nuk

janë aspak të hapur për të ndryshuar apo rishikuar aspekte të bindjeve të tyre politike.

Edhe pse këto gjetje janë shumë të nevojshme për përshtatjen e qasjeve që synojnë informimin e grupeve dhe audiencave specifike demografike, eksperimenti i anketimit deliberativ na jep një tjetër mësim të rëndësishëm. Ndonëse pjesëmarrësit në anketimin kombëtar raportuan se ishin më të hapur për të dëgjuar perspektiva të ndryshme por më pak për të ndryshuar të tyre, analiza krahasuese mes pjesëmarrësve të grupit eksperimental dhe grupit të kontrollit tregoi se as "ndryshimi i këndvështrimeve" nuk është aq i pamundur. Dhënia e më shumë njohurive dhe informacionit të besueshëm, krijimi i mundësive për të shkëmbyer ide e mendime me anëtarë të tjerë të grupit si dhe për të bashkëvepruar me ekspertë janë mënyra të rëndësishme për arritjen e konsensusit dhe krijimin e opinioneve të informuara. Në fakt, kjo gjë mund të jetë mjaft e vështirë për t'u realizuar në një kohë të shkurtër për tema mjaft të polarizuara dhe të politizuara, por përfitimi në planin afatmesëm dhe afatgjatë është i paçmueshëm. Kjo do të jetë veçanërisht e vlefshme nëse diskutimi i informuar praktikohet më shpesh si instrument për të zhvilluar mendimin kritik, edhe nëse ai jo gjithmonë rezulton me konsensus që në fillim.

# SHTOJCAT

## I. TË DHËNAT DEMOGRAFIKE TË KAMPIONIT, ANKETIMI KOMBËTAR (N=1200)

<b>Gjinia</b>	
Mashkull	44.9%
Femër	55.1%
<b>Grupmoshat</b>	
Deri në 24 vjeç	13.3%
25 - 34 vjeç	19.6%
35 - 44 vjeç	14.9%
45 - 54 vjeç	16%
55 - 64 vjeç	17.2%
65 - 74 vjeç	11.4%
75 - 84 vjeç	6.3%
85 + vjeç	1.2%
<b>Vendbanimi</b>	
Urban	68.6%
Rural	31.4%
<b>Niveli arsimor</b>	
Pa arsim ose arsim fillor të papërfunduar	1.4%
Me arsim fillor (4/5 klasë shkollë) të përfunduar	7.2%
Me arsimin e detyrueshëm (arsim 8/9-vjeçar) të përfunduar	19.6%
Me arsim të mesëm të përfunduar	43.1%
Arsim universitar të përfunduar ose më shumë	27.7%
Refuzim	1.0%
<b>Statusi i punësimit</b>	
I/E punësuar	46.9%
I/E papunë	19.3%
Student/e	6.0%
Pensionist/e	20.9%
Tjetër	5.4%
Refuzim	1.6%
<b>Spektori i punësimit</b>	
Publik	27.6%
Privat	72.4%

<b>Niveli i të ardhurave të rregullta mujore individuale (Neto)</b>	
Pa të ardhura	22.5%
Deri në 30.000 Lekë / muaj	33.2%
Nga 30 001 – 50 000 Lekë / muaj	21.2%
Nga 50 001 – 70 000 Lekë / muaj	12.5%
Mbi 70 001 – 100 000 Lekë / muaj	1.1%
Mbi 100 000 Lekë / muaj	0.6%
Refuzim	8.9%

## II. PËRBËRJA DEMOGRAFIKE E GRUPIT EKSPERIMENTAL DHE GRUPIT TË KONTROLLIT

Të dhënat demografike	Grupi eksperimental		Grupi i kontrollit	
	N	%	N	%
<b>Gjinia</b>				
Femër	62	57.4	60	55.6
Mashkull	46	42.6	48	44.4
<b>Grupmosha</b>				
Deri në 24 vjeç	34	31.5	20	18.5
25 - 34 vjeç	14	13.0	31	28.7
35 - 44 vjeç	19	17.6	13	12.0
45 - 54 vjeç	14	13.0	19	17.6
55 - 64 vjeç	19	17.6	13	12.0
65 - 74 vjeç	7	6.5	12	11.1
75 - 84 vjeç	1	0.9	0	0
<b>Niveli arsimor</b>				
Pa arsim ose arsim fillor të papërfunduar	2	1.9	0	0.0
Me arsim fillor (4/5 klasë shkollë) të përfunduar	0	0.0	2	1.9
Me arsimin e detyrueshëm (arsim 8/9-vjeçar) të përfunduar	2	1.9	10	9.3
Me arsim të mesëm të përfunduar	35	32.4	44	40.7
Arsim universitar të përfunduar ose më shumë	69	63.9	49	45.4
Refuzim	0	0	3	2.8
<b>Statusi i punësimit</b>				
I/E punësuar	55	50.9	55	50.9
I/E papunë	20	18.5	25	23.1
Student/e	10	9.3	13	12.0
Pensionist/e	17	15.7	12	11.1



Tjetër	4	3.7	3	2.8
Refuzim	2	1.9	55	50.9
<b>Sektori i punësimit</b>				
Publik	35	32.4	16	14.8
Privat	24	22.2	40	37.0
<b>Niveli i të ardhurave të rregullta mujore individuale (Neto)</b>				
Pa të ardhura	19	17.6	33	30.6
Deri në 30.000 Lekë / muaj	26	24.1	28	25.9
Nga 30 001 – 50 000 Lekë / muaj	28	25.9	25	23.1
Nga 50 001 – 70 000 Lekë / muaj	13	12.0	9	8.3
Mbi 70 001 – 100 000 Lekë / muaj	0	0.0	2	1.9
Mbi 100 000 Lekë / muaj	1	0.9	2	1.9
Refuzim	21	19.4	1	0.9

### III. VLERËSIMI I AKTIVITETIT

Në përgjithësi, aktiviteti katërditor pati një vlerësim shumë pozitiv nga pjesëmarrësit. Në mbarim të diskutimeve, pjesëmarrësve iu kërkua të plotësonin një formular vlerësimi për të gjithë eksperimentin. Në një shkallë nga 0 (humbje kohe) në 10 (jashtëzakonisht i vlefshëm), 72% thanë se i gjithë aktiviteti në tërësi ishte jashtëzakonisht i vlefshëm. Mesatarisht, 55% e pjesëmarrësve raportuan se materialet informuese iu dhanë informacione të vlefshme paraprake për secilën temë. Kontributi i diskutimeve në grupet e organizuara për sqarimin e pozicioneve për secilën nga temat u vlerësua nga 50% si “jashtëzakonisht i vlefshëm” dhe 40% si “jashtëzakonisht i vlefshëm” për seancat plenare me ekspertët.

Po ashtu, për sa i përket diskutimeve në grupe të vogla, në një shkallë nga 1 (aspak dakord) në 5 (plotësisht dakord), 87% e pjesëmarrësve ishin dakord se formati i diskutimeve në grupe të organizuara “*iu dha mundësinë të gjithëve për të marrë pjesë në diskutime*”. 65% e pjesëmarrësve nuk ishin aspak dakord me pohimin se “*moderatorët e grupeve të tyre tentonin të ndikonin te grupi me pikëpamjet e tyre politike personale*”. 69% ishin dakord se “*anëtarët e grupit tim morën pjesë në mënyrë relativisht të barabartë në diskutime*”. Ndërkohë, 79% ishin dakord se “*platforma e diskutimeve u përpoq që të merrte parasysh edhe argumentet kundër*” dhe 72% ishin plotësisht dakord se “*në diskutime u mbuluan aspekte të rëndësishme të çështjeve*”.

Në përgjithësi, 63% e pjesëmarrësve arritën në përfundimin se “*mësova shumë rreth njerëzve shumë të ndryshëm nga unë*”. Në formularin e vlerësimit, në pjesën e komenteve, pjesëmarrësit kishin theksuar vlerën e informacionit të dhënë për temat dhe mundësinë për të marrë parasysh pikëpamjet e ndryshme ndaj problemeve të paraqitura dhe për t'i diskutuar ato me specialistë të fushës. Një pjesëmarrës tha: “*Jam shumë i kënaqur me këtë aktivitet, por do të doja që aktivitetet të tilla të mos organizoheshin vetëm një herë si dhe të gjendej një mënyrë që zëri ynë të shkojë realisht në Parlament*.” Këto vlerësime dhe komente shumë pozitive për procesin tregojnë se diskutimet e informuara janë të mundshme dhe të vlefshme për qytetarët.

### IV. PYETËSORI I ANKETIMIT DELIBERATIV

#### Intervistuesi e fillon intervistën si më poshtë:

Përshëndetje! Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në konsultim me Qendrën për Demokraci Pjesëmarrëse (*Center for Deliberative Democracy*) pranë Universitetit të Stanford në ShBA po kryen një anketim për qëndrimet dhe mendimet e qytetarëve shqiptarë për një sërë çështjesh politike dhe social-ekonomike. Ju

jeni zgjedhur rastësisht për të qenë pjesë e këtij studimi. Nëse pranoi të bëheni pjesë e këtij anketimi, **IDM garanton anonimin dhe fshehtësinë e përgjigjeve tuaja.**

Nëse pranoi të bëheni pjesë e këtij anketimi, ju mund të bëheni pjesë e një aktiviteti katërditor në Tiranë me shpenzime të paguara dhe për të cilin do të kompensoheni me një tarife ditore.

Ky anketim po realizohet në kuadër të Projektit “Mbështetje për Parlamentin dhe Edukimin Qytetar – PACEP”, i mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe i zbatuar nga NDI, IDM dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Nr.	Kodi i Intervistuesit	Data	Bashkia	Njësia Administrative	Qyteti/Fshati
-----	-----------------------	------	---------	-----------------------	---------------

Le të fillojmë me disa pyetje për qëndrimet tuaja në përgjithësi në lidhje me politikën.

1. Në përgjithësi, sa i/e kënaqur jeni me mënyrën si funksionon demokracia në Shqipëri?

- Jashtëzakonisht i/e kënaqur
- Shumë i/e kënaqur
- Disi i/e kënaqur
- Disi i/e pakënaqur
- Aspak i kënaqur
- Nuk e di

2. Në përgjithësi, sa të rëndësishme i konsideroni partitë politike për cilësinë e qeverisjes?

Jashtëzakonisht të parëndësishme	në mes										Jashtëzakonisht të rëndësishme	Nuk e di
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	

## V. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE

3. Në një shkallë nga 0 në 10, ku 0 është “E kundërshtoj tërësisht” dhe 10 është “E mbështes plotësisht”, sipas mendimit tuaj, si i konsideroni masat e mëposhtme për të përmirësuar punën dhe rolin e Parlamentit?

	E kundërshtoj tërësisht					Neutral					E mbështes plotësisht		Nuk e di
	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	
Konsultimi me qytetarët dhe grupet e interesit të bëhet i detyrueshëm për të gjitha projektligjet, pavarësisht kostove dhe kohës së nevojshme.													

	E kundërshtoj tërësisht					Neutral					E mbështes plotësisht					Nuk e di
Miratimi i një ligji të unifikuar për referendimet dhe nismat ligjore qytetare.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10					99
Parashikimi i një buxheti (fonde publike) të veçantë për të mbuluar kostot e nisjes së një referendumi apo nismës ligjore qytetare.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10					99
Vendosja e detyrimit për të organizuar referendime për çështje të rëndësishme.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10					99

#### 4. Duke përdorur të njëjtën shkallë, sa të rëndësishme besoni se janë masat e mëposhtme për përmirësimin e demokracisë në Shqipëri?

	E kundërshtoj tërësisht					Neutral					E mbështes plotësisht					Nuk e di
T'i mundësohet opozitës që të kryesojë të paktën 1/3 e komisioneve parlamentare.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10					99
T'i mundësohen opozitës më shumë burime njerëzore për të ushtruar kontrollin dhe mbikëqyrjen e qeverisë.																
T'u mundësohet zgjedhësve që të nënshkruajnë peticione online dhe të detyrojnë parlamentin të diskutojë për çështje të rëndësishme për publikun.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10					99
Krerët e institucioneve të pavarura (të cilët ndihmojnë kontrollin dhe llogaridhënien e ekzekutivit) të zgjidhen me shumicë të cilësuar (2/3) e votave në Parlament.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10					99
Të rriten dhe forcohen kompetencat e institucioneve të pavarura (p.sh. KLSH, Avokati i Popullit etj.) në kontrollin ndaj qeverisë, përfshirë edhe kompetenca ndëshkuese (p.sh. gjyba).	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10					99

## VI. DEMOKRACIA E BRENDSHME E PARTIVE POLITIKE

5. Në një shkallë nga 0 në 10, ku 0 është “Jashtëzakonisht të parëndësishme” dhe 10 është “Jashtëzakonisht të rëndësishme”, sa të rëndësishme apo të parëndësishme janë masat e mëposhtme për përmirësimin e llogaridhënies dhe demokracisë së brendshme të partive politike në Shqipëri?

	Jashtëzakonisht të parëndësishme	Neutral					Jashtëzakonisht të rëndësishme					Nuk e di
Të bëhen publike online statutet dhe strukturat e brendshme të partive politike.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99
Të vendosen mekanizma konkurrimi brenda partive politike (p.sh., primaret e kandidatëve për zgjedhjet vendore dhe kombëtare).	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99
Të rritet financimi publik për partitë dhe kandidatët.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99
Të certifikohen financat e partive politike nga kompani ndërkombëtare	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99

## VII. REFORMA E SISTEMIT ZGJEDHOR

6. Në një shkallë nga 0 në 10, ku 0 është “aspak dakord” dhe 10 është “plotësisht dakord”, sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme?

	Aspak dakord	Neutral					Plotësisht dakord					Nuk e di
Sistemi aktual zgjedhor për Kuvendin e Shqipërisë e pasqyron plotësisht vullnetin e qytetarëve.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99
Ndarja administrativo-territoriale e vitit 2014 imponon zona elektorale të cilat e deformojnë vullnetin e zgjedhësve në votime për zgjedhjet lokale ose parlamentare.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99

7. Në një shkallë nga 0 në 10, ku 0 është “E kundërshtoj tërësisht” dhe 10 është “E mbështes plotësisht”, çfarë mendimi keni për ndryshimet e mëposhtme të sistemit zgjedhor?

	E kundërshtoj tërësisht					Neutral					E mbështes plotësisht					Nuk e di
Kalimi nga sistemi aktual proporcional rajonal në sistemin proporcional kombëtar (me vetëm një listë kombëtare).	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10					99
Kalimi tek listat plotësisht të hapura në sistemin aktual zgjedhor.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10					99
Kalimi në sistem të pastër mazhoritar (deputeti i çdo zone zgjidhet me shumicën e votave të qytetarëve).	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10					99
Rikthimi në sistemin e mëparshëm zgjedhor me zgjedhjen e 100 deputetëve me sistem mazhoritar dhe 40 me sistem proporcional.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10					99

8. Në të njëjtën shkallë, sa e mbështesni apo kundërshtoni faktin që qytetarët shqiptarë që jetojnë jashtë vendit të mund të votojnë në zgjedhjet në Shqipëri?

E kundërshtoj tërësisht	Neutral					E mbështes plotësisht					Nuk e di
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99

9. Në një shkallë nga 0 në 10, ku 0 është “e kundërshtoj tërësisht”, 10 është “e mbështes plotësisht”, dhe 5 është “Neutral”, çfarë mendimi keni për pohimet e mëposhtme?

	E kundërshtoj tërësisht					Neutral					E mbështes plotësisht					Nuk e di
Qytetarëve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit duhet t’u mundësohet votimi për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri pranë misioneve tona diplomatike në shtetet e huaja.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10					99

	<b>E kundërshtoj tërësisht</b>	<b>Neutral</b>										<b>E mbështes plotësisht</b>	<b>Nuk e di</b>
Qytetarëve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit duhet t'u mundësohet votimi për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri me postë të zakonshme.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	
Qytetarëve shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit duhet t'u mundësohet votimi elektronik për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	
Shqipëria duhet të sigurojë vende të dedikuara në parlament për të cilat diaspora shqiptare (qytetarët shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit) të votojë dhe të zgjidhet.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	

### VIII. IMIGRIMI EKONOMIK NË SHQIPËRI

10. Në një shkallë nga 0 në 10, ku 0 është “e kundërshtoj tërësisht”, 10 është “e mbështes plotësisht”, dhe 5 është “neutral”, çfarë mendimi keni në përgjithësi për pohimet e mëposhtme?

	<b>E kundërshtoj tërësisht</b>	<b>Neutral</b>										<b>E mbështes plotësisht</b>	<b>Nuk e di</b>
Shqipëria duhet të jetë e hapur të pranojë fuqi të huaj punëtore (imigrantë).	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	
Shqipëria duhet të nxisë bizneset që të paguajnë paga më të larta për qytetarët shqiptarë dhe jo të importojnë imigrantë të huaj.													
Imigrantët përmirësojnë shoqërinë tonë duke sjellë ide e kultura të reja.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	
Imigrantëve të rregullt në Shqipëri duhet t'u njihet e drejta për të votuar në zgjedhjet vendore.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	

## IX. NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE MJEDISI

Tani dua t'ju bëj disa pyetje për të marrë mendimin tuaj në lidhje me mbrojtjen e mjedisit.

11. Sipas mendimit tuaj, sa serioze është ndotja e ajrit në zonën tuaj?

- Shumë serioze
- Disi serioze
- Neutral
- Jo shumë serioze
- Aspak serioze
- Nuk e di

12. Sipas mendimit tuaj, sa serioz është kërcënimi i ngrohjes globale?

- Shumë serioze
- Disi serioze
- Neutral
- Jo shumë serioze
- Aspak serioze
- Nuk e di

13. Në një shkallë nga 0 në 10, ku 0 është "E kundërshtoj tërësisht" dhe 10 është "E mbështes plotësisht", sa i kundërshtoni apo mbështesni masat e mëposhtme për parandalimin e ndotjes së ajrit?

	E kundërshtoj tërësisht	Neutral										E mbështes plotësisht	Nuk e di
Shqipëria duhet të bëjë të detyrueshëm emetimin zero të karbonit për makinat, kamionët, autobusët deri në 2035.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	
Shqipëria duhet të ndalojë importin e makinave të përdorura më shumë se 5 vjet	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	
Jam i gatshëm të paguaj më shumë taksë në mënyrë që të mbrojmë mjedisin.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99	

Jam dakord që në qytetet e mëdha të krijohen zona me emetim të ulët (p.sh. në qendër të qytetit të lejohet qarkullimi vetëm i mjeteve elektrike)	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99
--	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----

Në vijim kemi disa pyetje të tjera lidhur me qëndrimet tuaja në përgjithësi në lidhje me politikën.

14. Në një shkallë nga 0 në 10, ku 0 është “aspak dakord” dhe 10 është “plotësisht dakord”, si do t’i vlerësoni secilin nga pohimet e mëposhtme?

	Aspak dakord					Neutral					Plotësisht dakord					Nuk e di
Deputetët dhe politikanët i kushtojnë shumë vëmendje mendimit të njerëzve të zakonshëm.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99				
Shumë çështje të politikave publike dhe ligjeve janë aq të ndërlikuara sa që njerëzit e zakonshëm e kanë të vështirë të kuptojnë se ç’po ndodh.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99				
Njerëzit e zakonshëm kanë ndikim në punën e Parlamentit.	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99				

15. Sa njohuri keni për rolin kontrollues dhe mbikëqyrës të parlamentit mbi qeverinë?

- Jashtëzakonisht shumë
- Shumë
- Mesatarisht
- Pak
- Aspak
- Nuk e di

16. Në parim, sa të rëndësishëm e konsideroni kontrollin dhe mbikëqyrjen e qeverisë nga parlamenti?

Jashtëzakonisht të parëndësishëm					Neutral					Jashtëzakonisht të rëndësishëm					Nuk e di
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99				



17. Në Shqipëri sa efektiv është kontrolli dhe mbikëqyrja e qeverisë nga parlamenti?

Jashtëzakonisht të jo efektiv					Neutral					Jashtëzakonisht efektiv	Nuk e di
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	99

18. Në përgjithësi sa njohuri keni për organizimin e brendshëm të partive politike në Shqipëri?

- Jashtëzakonisht shumë
- Shumë
- Mesatarisht
- Pak
- Aspak
- Nuk e di

19. Në përgjithësi, sa i/e interesuar jeni për politikën?

- Jashtëzakonisht i/e interesuar
- Shumë i/e interesuar
- Mesatarisht i/e interesuar
- Pak i/e interesuar
- Aspak i/e interesuar
- Nuk e di

20. Sa kuptoni ju personalisht nga ajo që ndodh në politikë dhe Parlament?

- Thuajse gjithçka
- Shumë
- Pjesërisht
- Pak gjëra
- Aspak
- Nuk e di

21. Sa besim keni se Parlamenti në përgjithësi bën atë që është e drejtë (gjënë e duhur)?

- Jashtëzakonisht shumë
- Shumë

- Mesatarisht
- Pak
- Aspak
- Nuk e di

22. Sa të informuar mendoni se janë deputetët për prioritetet dhe shqetësimet e qytetarëve në vend?

- Jashtëzakonisht shumë
- Shumë
- Mesatarisht
- Pak
- Aspak
- Nuk e di

23. Sa të gatshëm do të ishit për të kontaktuar me politikanë ose deputetë qoftë fizikisht, qoftë me shkrim apo në forma të tjera?

- Jashtëzakonisht i gatshëm
- Shumë i gatshëm
- Mesatarisht
- Pak i gatshëm
- Aspak i gatshëm
- Nuk e di

24. A votuat në zgjedhjet e fundit parlamentare?

- Po
- Jo
- Refuzoj të përgjigjem

25. Sa i gatshëm jeni të lexoni apo të dëgjoni njerëz që kundërshtojnë mendimet tuaja dhe ju ofrojnë një këndvështrim tjetër për çështjet politike?

- Jashtëzakonisht i gatshëm
- Shumë i gatshëm
- Mesatarisht
- Pak

- Aspak
- Nuk e di

**26. Sa i hapur jeni për të ndryshuar apo rishikuar aspekte të bindjeve tuaja politike?**

- Jashtëzakonisht i hapur
- Shumë i hapur
- Mesatarisht
- Pak
- Aspak
- Nuk e di

## **X. PËRVETËSIMI I NJOHURIVE TË PËRGJITHSHME**

Tani po vijmë në disa pyetje faktike për të cilat jo çdokush mund të ketë informacion apo njohuri. Nëse sheh se nuk e di përgjigjen e ndonjë pyetjeje, mos u shqetëso për të. Thjesht thuaj “nuk e di” dhe do të kalojmë në pyetjen tjetër.

**27. Sipas Rregullores së Funkcionimit të Kuvendit, a mund të merrni pjesë ju si qytetar në mbledhjet e komisioneve të përhershme parlamentare?**

- Po, mund të marr pjesë në çdo rast.
- Po, mund të marr pjesë vetëm nëse paraqes një kërkesë paraprakisht.
- Po, mund të marr pjesë vetëm nëse komisioni e vendos me shumicë votash.
- Jo, nuk mund të marr pjesë.
- Nuk e di

**28. Shqipëria nuk ka një ligj për (vetëm një përgjigje)::**

- Referendumet
- Nismat ligjore
- Konsultimet publike
- Të drejtën për informim
- Të gjitha sa më sipër
- Nuk e di

29. Cilat nga të mëposhtmet (nëse ka) janë të vërteta për sistemin që përdoret aktualisht për zgjedhjen e deputetëve të Kuvendit? (lejohet më shumë se një përgjigje)

- Votuesit duhet me patjetër të votojnë për partitë dhe kandidatët e pavarur
- Kandidatët renditen në listat e partive sipas rendit alfabetik
- Votuesit mund të shprehin preferencën e tyre për një kandidat partie
- Të gjitha sa më sipër
- Asnjë nga të mësipërmet
- Nuk e di

30. Sipas Kodit Zgjedhor, a mund të votojë diaspora shqiptare (qytetarë shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit) në zgjedhjet vendore dhe parlamentare në Shqipëri?

- Po, mund të votojë.
- Po, mund të votojë vetëm në zgjedhjet parlamentare.
- Po, mund të votojë vetëm në zgjedhjet vendore.
- Jo, nuk mund të votojë.
- Nuk e di

31. Sipas ligjit për partitë politike, cili është organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive?

- Parlamenti
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- Kontrolli i Lartë i Shtetit
- Të gjitha sa më sipër
- Asnjë nga të mësipërmet
- Nuk e di

32. Sipas ndarjes administrativo-territorial të vitit 2014 Shqipëria përbëhet nga:

- 16 qarqe dhe 34 bashki
- 12 qarqe dhe 56 bashki
- 3 qarqe dhe 25 bashki
- Asnjë nga më sipër
- Nuk e di

**33. Në vitin 2020, sa ishte niveli i papunësisë në Shqipëri?**

- Nën 10%
- Midis 10% dhe 20%
- Midis 20% dhe 30%
- Mbi 30%
- Nuk e di

**34. Sipas mendimit tuaj, ligji i ri për të huajt (2021) në Shqipëri lehtëson:**

- Procedurat e qëndrimit dhe punësimit të të huajve për të gjithë llojet e punësimit
- Procedurat e lejes së punës për punëtorët e kualifikuar
- Procedurat e lejes së punës për punëtorët e pakualifikuar
- Të gjitha sa më sipër
- Asnjë nga të mësipërmet
- Nuk e di

**35. A ka Shqipëria ndonjë ligj për ndryshimet klimatike?**

- Po, kam dëgjuar që ka një ligj të tillë.
- Jo, nuk jam në dijeni nëse ka një ligj të tillë.
- Jo, nuk ka një ligj të tillë.

**XI. TË DHËNA DEMOGRAFIKE**

Të kalojmë tani tek pyetjet e fundit. Disa pyetje të shkurtra në lidhje me ju.

**1: Shëno gjininë**

- Femër
- Mashkull

**2: Moshë: \_\_\_\_\_**

**3: Niveli arsimor**

- Pa arsim ose arsim fillor të papërfunduar
- Me arsim fillor (4/5 klasë shkollë) të përfunduar
- Me arsimin e detyrueshëm (arsim 8/9-vjeçar) të përfunduar

- Me arsim të mesëm të përfunduar
- Arsim universitar të përfunduar ose më shumë
- Refuzim

#### 4: Statusi i punësimit

- I/E punësuar
- I/E papunë
- Student/e
- Pensionist/e
- Tjetër \_\_\_\_\_
- Refuzim

#### 5: Sektori i punësimit

- Publik
- Privat

#### 6: Niveli i të ardhurave të rregullta mujore individuale (Neto)

- Pa të ardhura
- Deri në 30.000 Lekë / muaj
- Nga 30 001 – 50 000 Lekë / muaj
- Nga 50 001 – 70 000 Lekë / muaj
- Mbi 70 001 – 100 000 Lekë / muaj
- Mbi 100 000 Lekë / muaj
- Refuzim

## FTESË PËR AKTIVITETIN

Në datat 18-21 nëntor 2021 (e enjte deri të shtunën), IDM do të organizojë një aktivitet me një numër të caktuar të anketuarish për të diskutuar për temat e këtij anketimi. Ky aktivitet do të bëhet në Tiranë (adresa e saktë do t'u njoftohet nga organizatorët) dhe pjesëmarrësve do t'u drejtohen ekspertë të njohur dhe figura publike në seanca plenare dhe më pas do të zhvillojnë diskutime në grupe të vogla për temat dhe zgjidhjet e mundshme për sfidat përkatëse.

Nëse e pranoni ftesën tonë dhe jeni përzgjedhur, IDM do të mbulojë të gjitha kostot e akomodimit dhe do t'ju paguajë një tarifë ditore simbolike për të katër ditët e këtij aktiviteti.

### 1. A jeni i gatshëm të merrni pjesë në këtë aktivitet sipas këtyre kushteve të mësipërme?

- Po, patjetër
- Me gjasë Po
- Me gjasë Jo
- Jo, përfundimisht

### 2. A e keni bërë vaksinën kundër Covid-19?

- Po, i kam bërë të dyja dozat
- Po, kam bërë vetëm dozën e parë
- Jo, por kam planifikuar ta kem bërë deri në nëntor
- Jo, nuk do ta bëj
- Tjetër \_\_\_\_\_

Vetëm për ata të anketuar që zgjedhën një nga opsionet 1-3.

Kontakti i pjesëmarrësit: Celular \_\_\_\_\_ dhe Email \_\_\_\_\_

JU FALEMINDERIT!

### TË PLOTËSOHET NGA INTERVISTUESI (për aktivitetin):

#### 3. Sa interes tregoi i anketuari për temat e trajtuara nga pyetësi?

- Jashtëzakonisht shumë interes
- Shumë interes
- Interes mesatar
- Pak interes
- Aspak interes

#### 4. Sa serioz/e dhe i/e vëmendshme ishte ai/ajo gjatë dhënies së përgjigjeve?

- Jashtëzakonisht shumë
- Shumë
- Mesatarisht
- Pak
- Aspak